

KOLEC TOPALLI

NGA VEPRA “FJALOR ETIMOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE” II

B

bagolinë f. “bar me gjethe të holla, që rritet deri në një gjysmë metri, i ngjashëm me tërfilin, lat. *Lotus corniculatus*”. Quhet edhe *bari i livadhit, groshëza, lulja e fshesës, lulja e lepurit* etj. Fjalë relativisht e re në gjuhën shqipe me përhapje krahinore në Veri. Është huazim nga it. *bagolina*, fjalë e dialektit venecian, që ka kuptimin “shkop i hollë” nga lat. *baccum* “shkop” (khs. it. *bacchetta* “thupër”) duke u emërtuar bima nga kërcelli i saj i hollë e i gjatë. (Gazulli 52).

baj fol. “mbaj, bar”. Fjalë e trashëguar, që me këtë formë i përket dialektit gegë. Del për herë të parë te Buzuku: *biri të mos banjë kualetë e përintit*. Toskërishtja në vend të saj përdor përgjithësisht *mbaj* e *mbar*. Por ndërmjet këtyre foljeve ka jo vetëm ndryshime fonetike, por edhe kuptimore, sepse foljen *mbaj* e ka me të njëjtin kuptim edhe gegërishtja, e cila *bāj* e përdor për “mbar, mbart” me kuptimin e lëvizjes e jo të qëndrimit që ka folja *mbaj*, si p.sh.: *Baj venë e pi ujë*. Si folje ka lidhje apofonie me *bie* ~ *bjerë* dhe me *bar*, *mbar*, *mbart*, ku format qëndrojnë në kundërvënien apofonike /e/ ~ /o/, me zhvillimet /e/ > /je/, /ie/ dhe /o/ > /a/. Lëngëzorja -r fundore te *bā-j* përkundrejt *mbar* është zhdukur në formën e pashtjelluar me prapashtesën -të, ku ndeshja e saj me dhëmboren e prapashtesës e ka shndërruar në -j (khs. *bajtë*), ashtu si ka ndodhur në shumësin *bijtë* nga **birtë* dhe si te ndajfolja *shpejt* nga **shpjert*; si rrjedhim, pjesoret *bartë* e *mbartë* janë ndërtime të mëvonshme analogjike. Me këtë bazë, **bar* nga ie. *b^hor-*, kjo folje lidhet me ind. vj. *bhārati*, arm. *berem*, gr. φέρω, lat. *fero*, irl. vj. *biru*, got. *bairan*, sll. vj. kish. *berō*, të gjitha me kuptimin “mbar, sjell” (Meyer) nga rrënja ie. *b^her-*. (Meyer EW 35, Walde-Pokorny II 154, Walde-Hofmann I 483, Jokl IF 37, 1916/17, 103, Çabej SE II 131, Huld BAE 43).

bajgúsh m. Është emri i një kandrre, që rri përgjithësisht përdhe, një lloj brumbulli, lat. *Geotrupes stercorarius*, *Copris*. Është fjalë dialektore e toskërishtes. Me emra të tjerë kjo kandërr quhet *brumbulli i plehut, brumbulli i bajgave, bubaç, bubazhel, zhuzhaku i bajgave* etj. Meqenëse kjo kandërr rri nëpër plehëra, emërtimi i saj është bërë prej fjalës *bajgë*, që ka marrë prapashtesën -ush.

bálla sh. “gjysma sholle a gome për këpucë”. Fjalë dialektore e toskërishtes, që përdoret vetëm në shumës. Si fjalë krahinore e Jugut, burimin e ka nga gr. re *μάλα* “top”, me sa duket, duke u mbështetur në elementin e përbashkët “gomë, prej gome”. Me këtë fjalë lidhen edhe foljet *mballoj* e *mballos* “arnoj, mbush” me protezën e sonantes *m-*; kurse *mballomë* me kuptimin “arnë” vjen nga gr. re *μάλωμα*.

báshkë ndf. “tok, njësh”. Është fjalë e vjetër e shqipes, e mbarë gjuhës. Shfaqet për herë të parë te Buzuku: *e përse aj të embëlidh popullinë gjithë bashkë*. Për dialektin e Jugut, Matrënga: *ishtë bashkë*. Bardhi e ka me një *m-* protetike: *Mbashkë me mamënë e me tatënë*. Formime të brendshme nga kjo ndajfolje janë: folja *bashkoj* e emri foljor *bashkim*, që përdoret edhe si antroponim; tek arbëreshët e Italisë *bashkënj* me të njëjtin kuptim; ndajfoljet *bashkas* ~ *bashkazi* e *bashkarisht*, emri *bashkí* i krijuar nga Mati Logoreci; *bashkërtí*, që del së pari te Bogdani dhe e ka edhe arbërishtja e Italisë; *bashkarí* e *bashkní* në Fjalorin e Bashkimit; *bashkme* për “bashkim, martesë” te arbëreshët e Italisë; mbiemri *i bashkueshëm*, që del në Fjalorin e Bashkimit, ndajfolja *së bashku*, një rrjedhore e paranyjzuar (khs. *së paku*), mbiemri *të bashkë* në arbërishten e Greqisë, si edhe një varg kompozitash të krijuara përgjithësisht nga intelektualë në shekullin e fundit. Për burimin e fjalës, morfologjikisht ndajfolja mund të ndahet në *ba-shkë*, ku elementi i dytë është prapashtesë (khs. *bluashkë*, *bjeshkë*), kurse elementi i parë, rrënja e fjalës, një **ba*, mund të afrohet me got. *ba*, gjerm. *beide* e ang. *both*, që përfaqësojnë numërorin kolektiv *dy*. Prandaj, në krye të herës *bashkë* do të ketë pasur kuptimin “të dy”, siç e kanë sot gjerm. *beide* dhe ang. *both*, ndërsa në një periudhë të mëvonshme do të jetë përgjithësuar edhe për sasi të tjera më të mëdha se numërori *dy*. Lidhja tjetër, që i është bërë kësaj ndajfoljeje, me lat. *fascia* “lidhje fashë”, irl. mes. *basc* “gjerdan” (Meyer, Çabej) paraqet vështirësi fonetike për evolucionin e grupit bashkëtingëllor /sk/ në gjuhën shqipe. (Meyer AS IV 80, Walde-Pokorny II 135, Ernout-Meillet 218, Walde-Hofmann I 460, Jokl LKU 170, Mann Lg. 17, 1941, 13, Çabej SE II 180, Demiraj 93, Orel AED 13, Kluge-Seebold 93).

besëtytë mb. “i dhënë pas besimeve të kota”. Fjalë e re në gjuhën shqipe, neologjizëm i shekullit të kaluar në truall të gegërishtes, kompozitë e formuar nga emri *besë* me kuptimin “besim” dhe mbiemri *tytë* “bosh, i zbrazët”, domethënë “besime të kota”. Për *tytë* khs. te Mjedja: *Shurdh' á vëndi e shpija tytë* (Juv.). Rrjedhoja të fjalës janë *bestytní* e *bestytnor*, ku prapashtesat dëshmojnë karakterin gegë të fjalës (khs. *burrni*, *burrnor*).

betéjë f. “ndeshje me armë”. Fjalë e re në gjuhën shqipe, huazim libror nga gjuhët romane: fr. *bataille*, it. *battaglia*, me burim nga lat. *batuëre* “rrah,

godas” (khs. fr. *battre*, it. *battere*). Ndryshimi i zanoreve mund të jetë bërë me një lexim të gabuar të fr. *bataille* (“batajë”) duke u lexuar *ai = e* si në rastet e tjera të asaj gjuhe.

bëltacë f. “farat së bashku me shtresën që i mban në zemrën e kungullit ose të pjeprit”, “shtresa si llurbë që zë uthulla e ndenjor, shtrati i uthullës”. Fjalë krahinore e gegërishtes, me përhapje në Shqipëri të Mesme, formim i brendshëm gjuhësor nga emri *baltë* me prapashtesën *-ac*, që me formantin e shumësit ka dhënë *bëltaca*, kurse *bëltacë* është një shumës i singularizuar, i formuar sipas skemës *caracë ~ caraca*.

bërbëlít fol. “shqiptoj fjalët përgjysmë, flas turbull”. Është formim i brendshëm i shqipes, krijim onomatopeik nga *bër-bër* dhe prapashtesa *-it*, me disimilim të lëngzores dridhëse (khs. *përpëlit* nga *për-për*). Emri *bërbëlítje* ka dalë nga folja.

bërtás fol. “thërras, gërthas”. E kryera e thjeshtë *brita* e *bërtita*, pjesorja *britë* e *bërtitë* / *bërtitur*. Është fjalë e mbarë gjuhës, që e kanë edhe arbëreshët e Italisë. Formim i brendshëm i shqipes, që dëshmohet më së pari te Buzuku: *tue britunë britnje en zemëret sime*. Morfologjikisht bën pjesë në klasën e foljeve me temë të thjeshtë në të kryerën e thjeshtë e në pjesore (*brita ~ britë*), që e kanë zgjeruar atë me prapashtesën *-is* / *-it* në të tashmen. Forma *brit* është edhe e mënyrës urdhërore, ku krahas kësaj përdoret edhe forma e re *bërtit*, e ndërtuar me temën e zgjeruar në të tashmen. Në të kryerën e thjeshtë e në pjesore kanë ndodhur dy ndryshime. Ndryshimi i parë ka ndodhur në formën e pashtjelluar, ku është shtuar bashkëtingëllorja *-t*, që është formanti i pjesores, e cila ka kaluar edhe në të kryerën e thjeshtë (khs. *mbar ~ mbartë ~ mbarta*). Ndryshimi i dytë ka ndodhur në të kryerën e thjeshtë duke kaluar edhe në pjesore: zanorja *-e* është shndërruar në *-i* (khs. *pres ~ prita*). Kështu, kjo folje ka ndjekur të njëjtën rrugë si *ngre ~ ngrita ~ ngritë*, ku kanë ndodhur ndryshimet e mësipërme. Pas kësaj analize, forma *brit* e së kryerës së thjeshtë dhe pjesores ka pasur formën **bre* në të tashmen. Me këtë bazë ajo lidhet përbrenda gjuhës me *brej* e *brimë*. Kjo lidhje përlligjet edhe me një folje tjetër, që ka të njëjtën lidhje: *thërras* e *thirr*, ku *-i*-ja vjen nga *-e*-ja, duke u lidhur kështu përbrenda gjuhës me foljen *therr*; khs. për këtë lidhje shprehjet: *m’u shkye zani* “bërtita sa munda”, *me zë të çjerrë* “me zë të shkyem”. Duke u shpjeguar me mjetet e shqipes, një lidhje me let. *brēka*, *brēkt* “qaj”, rus. *brešù* “leh” (Çabej) është më pak e mundshme.

Rrjedhojë e foljes është emri *britmë* nga rrënja *brit* me prapashtesën *-më* (khs. *ndihmë*), e cila shfaqet që te Budi: *britmet e gjamet së djemënet*. Në gegërishten veriperëndimore ky emër ka dhënë *brimë* me zhdukje asimilatore. Rrjedhoja të tjera janë: *bërtitje*, *bërtajë* e *bërtimë*, dy të fundit me përhapje

dialektore me të njëjtin kuptim. Nga *britmë* e *brimë* janë formuar *britmëtar* e *brimtar* “vajtues, gjëmëtar” e *britmarak* “që lëshon britma” (*zogj britmarakë*). Arbëreshët e Italisë kanë edhe *bërtisënj* e *bërtim* (Çabej SE II 213, Orel AED 23, Luka I 143, Topalli Fol. 127).

bërzánë f. “femër që posa është mbarsur, femër që mbarset shpejt ose që pjell shpesh”. Është fjalë e gegërishtes me përhapje krahinore, formim i brendshëm gjuhësor, e krijuar nga *bark-zanë*, ku ka rënë njëra prej tri bashkëtingëlloreve dhe është rrëgjuar zanorja e patheksuar. Për mënyrën e fomimit dhe kuptimin e saj shkon paralel me *shtatzanë*.

bërrákë f. “pellg uji, ujë amull”. Është fjalë kryesisht e gegërishtes, që e kanë edhe arbëreshët e Italisë dhe është bërë e mbarë gjuhës në ditët tona; me etimologji të paqartë. Dëshmohet për herë të parë te Buzuku: *dirgjë endë mot endë bërakët*. E kanë edhe autorët e tjerë dhe shfaqet në toponimi: në Tiranë një lagje me emrin *Brrakë*, në Veri *Përroni i Brrakës*, në Sllovë të Dibërës *Brrakë e Epër e Brrakat*, në Kastrat *Brrakçinë*. Për burimin e fjalës, lëngëzorja *-rr-* në trup të saj dëshmon se ka nisur me këtë fonemë, si rrjedhim, ajo ndahet në *bë-* + *rrakë*, ku *bë-* është parashtesa e njohur (khs. *bythë* nga *bë-* + *ith*), kurse rrënja **rak-* lidhet në shkallë indoeuropiane me rus. *reká* “lumë”, më tej me ind. vj. *ráyas* “rrjedhë”, irl. vj. *rían* e lat. *rívus* “përrua” etj. Kësisoj, ndërsa *rrëke* e *rrëkajë* janë huazime prej asaj fjale të sllavishtes, *bërrakë* është fjala shqipe që lidhet me të në shkallë indoeuropiane. Një lidhje me gr. βράγος (Çabej) paraqet vështirësi fonetike për t’u pranuar. (Meyer EW 33, Skok ER I 109, Walde-Pokorny I 694, Vasmer SL III 464, Çabej SE II 215, Orel AED 23).

bërrýl m. “vendi ku përthyeret krahu”. Fjalë e mbarë gjuhës, me përdorime të shumta, sidomos në frazeologji; me etimologji të diskutueshme. Dëshmohet së pari te Budi: *ō vīm bërrylatë përmbi iltert*. Me këtë formë edhe te Bardhi e Bogdani; por nëpër të folme dialektore gjenden edhe forma të tjera, që kanë dalë nga forma kryesore, si: *bryl*, *bërrul*, *brul*, *bërul*, *brur*, *burrul*, *bilur*, *bryll* (Leotti) etj. Me këto dëshmohet se fjala përbëhet nga dy rrokje, ku është thjeshtuar njëra prej tyre në disa forma (sidomos në Veri) dhe janë ndryshuar zanoret në disa të tjera (sidomos në Jug, ku *-y-* > *-u-*, *-i-*). Prandaj ndarja morfologjike e saj është *bë-rryl*, ku *bë-* është parashtesë (khs. *bythë* nga *bë-* + *ith*), kurse rrënja *rryl* lidhet përbrenda gjuhës me *rryl* “skërfyell, damar” me kuptimin “lidhje”, domethënë “vendi ku llëra lidhet me pjesën e sipërme të krahut”. Një hipotezë tjetër është ajo që e ndan fjalën në *ber-ul* duke e lidhur me *ber* “hark” dhe prapashtesën *-ul* (Çabej).

Rrjedhoja të fjalës janë: *bërrylak* “kthesë rruge a lumi”, *bërrylje* “këmbë e parë e bagëtisë së therur”, *bërrylas* “ijash, anash”. Shfaqet edhe në

toponimi, ku *Bërryli* është emri i një rruge në Tiranë. Shprehja “*u bë bërryl*” për një pijanec e ka burimin te it. *brillo* “çakërrqejf” duke u ndikuar nga *bërryl*-i me etimologji popullore. Në Veri, rrjedhoja *brrylk* është për “bylyzyk” (Dema). (Meyer EW 49, La Piana SLA Varia 5, Çabej SE II 217, Orel AED 23, Luka I 146).

bigë f. “një dru që ndahet dysh në majë”. Përdoret edhe për çdo send tjetër që ndahet dysh ose mbaron me dy maja, si: “mal me dy maja”, “degë lumi”, “mashë”, “darë druri”, “vinç me dy krahë”, “tufë lulesh në majë të një shkopi të ndarë dysh”, “gërshetat”, “duajt e misrit të korrur”; “shtiza e qerreve”, “piskrrat”, “delta e lumit” (Logoreci) etj. Është fjalë e mbarë shqipes, që e kanë edhe arbëreshët e Italisë; me burim të paqartë. Dëshmohet së pari te Bogdani: *me u munduem ndë një bigë n’Ferri*. Ka krijuar rrjedhoja të shumta, që kanë të gjitha kuptimin “dysh, me dy maja”, si: emrat *bigaçe* “furkaçe”, *bigël*, *bigllë* (“majë mali”), *bigëz*, *biglaçe*; mbiemrat *i bigët* e *bigëlosh*; foljet *bigoj* e *bigëzoj* me emrin *bigëzim*, ndajfolja *binga* (*mustaqet binga*) me epentezën e sonantes *-n-*, kompozita *veshëbigë* etj. Dëshmohet edhe në toponimi: *Bigçore*, *Biga e Ballezës*, *Biga e Çame*, *Biga e Shalës*, *Biga e Gimajt*, të gjitha në Veri; *Bizë* (në anë të Tiranës) nga *big(ë)-zë*; *Biglla e Boboshticës*, *Biglla e Drenovës*, *Biglla e Mesme* në Jug.

Për burimin e fjalës, *bigë* ashtu si *degë* përmban prapashtesën *-gë* (khs. *lëvozhgë*), kurse rrënja e fjalës mbetet një **bi-* me kuptimin “dy”. Një rrënjë të tillë me këtë kuptim ka latinishtja (khs. *bis* “dy herë”), por në gjuhën shqipe nuk ekziston si fjalë më vete. Prej shqipes fjala ka shkuar edhe në arumanishtje. (Meyer-Lübke REW 1095, Çabej SE II 225, Orel AED 25, Luka I 147).

binjak m. “dy fëmijë që lindin njëkohësisht, dy sende të ngjashme”. Fjalë e mbarë gjuhës, që del me disa variante në të folme të ndryshme; me burim të paqartë. Dëshmohet për herë të parë te Bogdani, që ka trajtën *binosh* për it. *gemello* në emërtimin e shenjzave, një fjalë që e ka Kastrati për bagëti e drurë. Forma të tjera të këtij emri janë: *binjok* (Shkodër), *binak* (Kosovë), *binok* (Pult), *binjar* (Çamëri), *binjarak* (Kristoforidhi), *binjosh* (Godin), *binjec* (Da Lecce), *bineq* (Gjakovë) si shumës i *binak*-ut, *binjore* (Giordano, Kamsi), *përbinjore* “dele a dhi që pjell për të dytën herë” etj. Folja *binjakëzoj* me emrin *binjakëzim* janë neologjizma të viteve të fundit. Emri *Binak* përdoret edhe si antroponim dhe patronim. Për burimin e fjalës, në të gjitha variantet dallohet një rrënjë *bin-* ~ *binj-* me kuptimin e numrit “dy”, që është zgjeruar me prapashtesa të ndryshme (*-ak*, *-ok*, *-ar*). Një rrënjë *bi-* me kuptimin “dy” del në gjuhën shqipe te emri *bigë*, por në fjalët e mësipërme prania e sonanteve *-n-* a *-nj-* të çon te lat. *bīni* “dy nga dy”. (Çabej SE II 237, Luka X 46).

bízgë f. “jashtëqitja e hollë e njeriut a e kafshëve kur i heq barku, purthë”. Fjalë e dialektit të Jugut me përhapje mjaft të gjerë (Vlorë, Lushnje etj.). Formim i brendshëm nga *bisk*, që përveç kuptimit “degë, filiz” ka edhe kuptimin “curril uji”. Në këtë kuptim të dytë *bizgë* ka pësuar një asimilim të bashkëtingëlloreve duke ndërruar edhe gjininë. Folja *bizgosem* për “më heq barku” dhe emri *bizgosje* janë formime të brendshme.

bjerr fol. “humb”, kr. thj. *bora*, pj. *bjerrë*. Fjalë e mbarë gjuhës, që shfaqet me trajta të ndryshme në të folme dialektore nga parashtesat që ka marrë: *dëbjer* në arbërishten e Italisë, *rbjer* në arbërishten e Greqisë, *zbier* në çamërishte, tek arbëreshët e Italisë dhe në Mandricë të Bullgarisë. Forma të tjera, si: *dëvjerr*, *vdjerr*, *djerr*, *bdjerr*, *vjer* etj. kanë dalë nga ndërrimet dialektore të grupeve bashkëtingëllore /bd/, /vd/, herë me ndërrim vendesh të fonemave, herë me rënien e njëres prej tyre. Forma të tjera janë krijuar me apofoninë kualitative, ku trajtave me /je/ nga /e/ u përgjigjen ato me /a/ nga /o/: *bār* “humb” në çamërishte, *bdar*, *vdar* e *dvar* tek autorët e vjetër.

Për etimologjinë e fjalës, kuptimisht dhe fonetakisht *bjerr* lidhet me *bie* dhe të dyja këto e kanë burimin nga rrënja ie. *b^her-* “bie” (Pedersen). Morfologjikisht, e tashmja *bjerr* është krijuar me analogji nga pjesorja *bjerrë*, ndërsa një formë më e vjetër e së tashmes është ruajtur tek arbëreshët: *bier*, ku -r-ja shfaqet për hir të formave të tjera me të cilat krijon sistem (urdh. *bir*, kr. thj. *bora*). Me këtë karakter sistemor kuptohet ruajtja e -r-së përkundrejt rënies së saj te *bie*, *shpie*, *shtie*. Për herë të parë fjala shfaqet te Buzuku me formën *bdjerr* nga *dëbjerr*: *E të bdjersh gjithë ata qi mundonjënë shpirtinë tem; Zemëra eme u bduor endë muo*. Bardhi ka foljen *me djerrë* për lat. “perdere” dhe emrin foljor *të djerrëtë* për lat. “Perditio”. Rrjedhoja të fjalës janë emri prejfoljor *bjerrje* dhe kompozitat *bjerrafat*, *bjerramot*, *bjerraditës*. (Meyer EW 70, Brugmann Gr. I² 446, Pedersen KZ 36, 1900, 325, Walde-Pokorny II 154, Boisacq 178, Mann Lg. 28, 1952, 33, Çabej SE II 253, Demiraj 104, Orel AED 28, Topalli Sist. bashk. 90).

blegërin fol. “thërrasin dhentë”. Fjalë e mbarë gjuhës, me këtë formë më tepër e Jugut, me formën *blegëron* më fort e Veriut. Forma të tjera janë *blegëret* e *blegërit*. Fjalë me burim të diskutueshëm. Mund të jetë krijim onomatopeik (Meyer), si në disa gjuhë të tjera (khs. lat. *belo-āre*, gjerm. *blöken*, sll. vj. kisht. *blekati*); por, duke u lidhur përbrenda gjuhës me *blegëtor*, rrënja e saj mund të jetë huazuar nga sll. (skr.) *blāgo* me kuptimin “pasuri, bagëti” duke marrë fundoren e foljeve të tjera të kësaj natyre (khs. *cicërin* e *cicëron*). Rrjedhoja të foljes janë *blegërimë* e *blegëritje*. (Camarda I 58, Meyer EW 38, Walde-Pokorny I 102, Walde-Hofmann I 95, Çabej SE II 258, Demiraj 104, Orel AED 28, Kluge-Seebold 120).

blej fol. “marr diçka duke e paguar”. Është fjalë e mbarë gjuhës, që dëshmohet për herë të parë në Fjalorthin e kalorësit gjerman Arnold von Harff (1497): *do daple* “do ta ble”. E kanë edhe të gjithë autorët e vjetër duke filluar me Buzukun: *mos tue blenë, mos tue shitunë*. Morfologjikisht, *blej* është folje me temë në zanore, sikurse *laj*, që vetëm më vonë ka marrë mbaresat e foljeve *-nj ~ -n*. Kjo del te autorët e vjetër, ku folja s’ka mbaresat vetore; Budi: *ō tregëtar qi shet e ble*; Bardhi: *Kush kã denarë amë e atë ble*. Me këtë përgjasohet bashkëtingëllorja hundore në rrënjë të foljes dhe lidhja me let. *apblendēt* e lit. *bliñde* “shikoj” (Çabej). Si temë me zanore gojore, *blej* mund të lidhet me ie. *b^hleu-* “rrjedh, kam plot, jam i mbushur”, prej së cilës kanë dalë gr. φλέω “kam plot, jam i mbushur plot e përplot”, lat. *fluo-ëre* “rrjedh”. Kuptimi *blej* mund të ketë dalë nga “kam” si në greqishte ose nga “rrjedh, kalon” si në latinishte. As gjuhët e tjera indoeuropiane nuk kanë ndonjë folje të veçantë për *blej*, por e kanë krijuar atë duke përdorur folje me kuptime të tjera, dhe kjo ngjet edhe në gjuhë gjenetike të njëjta; khs. fr. *acheter* e it. *comperare*, gjerm. *kaufen* e ang. *buy*. Nga *blej* është formuar *shpërblej ~ shpërblje*, që del së pari te Buzuku. Rrjedhoja të tjera janë *blemje / blerje* dhe *blerës*, në gegërishten veriore edhe *blejë* (khs. *blojë*). (Bopp 491, Meyer EW 39, Pedersen Rom. Jb. IX 1905, 211, Jokl Stud. 45, Walde-Pokorny II 212, Çabej SE II 259, Topalli Hund. 109, Orel AED 29).

blëtë f. “mizë mjalti”. Është fjalë e mbarë gjuhës, që e kanë edhe arbëreshët e diasporës dhe në disa të folme shënon, krahas bletës, edhe “zgojin” dhe “luzmën”. Autorët e vjetër krahas *blëtë* kanë edhe *mjalçë*. Kështu Bardhi ka: *Mjalcatë* “Apes”; kurse Bogdani i ka të dyja: *blëtë* e *mjalçëzë*. Rrjedhoja të emrit janë, formimet me prapashtesa: *blëz* “bar blete, lat. *Melissa officinalis*”, *bletas* “një lojë popullore”, si edhe neologjizmat *bletar* “bletërritës”, *bletore* “vend me zgjoje bletësh”. Emri ka kaluar edhe në toponimi: *Bletëz* (Gramsh), *Curri i Bjetës* (Aripë e Keqe - Pukë), *Guri i Bletës* (Korçë) etj. Përdoret edhe si emër familjesh.

Për etimologjinë e fjalës, një lidhje me *mjalhtë* është e dukshme dhe e pranueshme si nga ana kuptimore, ashtu edhe nga ana e formës (Stier), meqenëse ka një mbështetje të fortë në gjuhën shqipe: folja *bluaj* dhe emri *miell* i përkasin së njëjtës rrënjë, ku parësore është forma me *m-* (khs. gjerm. l. vj. *mëlo* “miell”, lat. *molo,-ëre* “bluaj”, gr. μύλη “mulli”, let. *milti* “miell”). Kësisoj, *mjalhtë* e *blëtë* kanë pasur të njëjtën rrënjë **melt-*, **mlet-*, që në njerin rast u zhvillua në *mjalhtë* (/e/ > /ja/), kurse në rastin tjetër u zhvillua në *blëtë* (**mlet-* > *m^blet* > *blëtë*). Një dukuri e tillë ka ndodhur edhe në greqishte, ku μέλισσα i ka të dyja kuptimet, “bletë” e “mjaltë” dhe pranë kësaj ka edhe formën me *b-*, βλίττω me kuptimin “nxjerr mjaltë”. Me këtë burim *blëtë* e *mjalhtë* të shqipes krahasohen me fjalët që kanë gjuhët e tjera për *mjalhtën*: gr.

μέλιττα, lat. *mēl*, arm. *metr*, irl. vj. *mil*, got. *miliþ* etj. Por forma *mbletë* që kanë disa të folme të Jugut, nuk është formë e ruajtur, por një risi e atij dialekti, e arritur me protezën e *m-së* para *b-së* (khs. *mblatë* nga lat. *oblāta*). Mendimi i Çabejt se *bletë* është një fjalë kulture e burimit të huaj, gr. vj. μέλιττα, paraqitet fonetikisht i vështirë për t'u pranuar (për punë të theksit). (Stier nr. 182, Camarda I 44, Meyer AS II 79, Schmidt KZ 50, 1922, 235, Jokl LKU 289, Tagliavini AD 84, Boisacq 624, Walde-Hofmann II 62, Pisani Saggi 1959, 120, Çabej SE II 262, Demiraj 105, Orel AED 29, Luka I 152).

bllacë f. “vend me ujë e me baltë, ligatinë”. *U bë bllacë* “u lag shumë”. Fjalë me përhapje krahinore në Shqipëri të Mesme, Lindore e Jugore. Ka krijuar rrjedhojat *bllacaroj* “e zbut diçka, e bëj si qull” dhe *bllacore* “lakror me miell misri”, kjo e fundit duke u nisur nga *qull-i*. Ka depërtuar edhe në toponimi, një fshat me këtë emër në Bulqizë dhe prej këndeje edhe si emër familjesh (*Bllaca* e *Bllaci*). Është huazim nga sll. (bullg.) блатце, deminutiv i sll. блато “kënetë, moçal”, Me këtë të fundit lidhet emri i fshatit *Bllatë* në Tropojë dhe në Dibër. Fjalë të tjera, që lidhet me këtë huazim sllav, janë: *bllatak* “kënetë”, *bllaçuk* “gropë me ujë shiu”, *bllatkë* (Krrabë) “vend i shembun në arë, që mban ujë”. Fjala mund të ketë hyrë nëpërmjet maqedonishtes në zonat kufitare. (Çabej SE II 272, Svane SLA 168, Ylli SLA I 33, II 91, FEG 30).

bllók m. “copë e madhe e një lënde të fortë”. Fjalë relativisht e re, që ka marrë shumë kuptime: “copë betoni, akulli etj.”, “grup ndërtesash”, “ngastër e madhe toke”, “fletore e trashë”, “pjesët e një mekanizmi” etj. Gegërishtja VP e shqipton me *-l-* alveolare (*blok*), forma me *-ll-* është e toskërishtes dhe e përgjithësuar në shqipen e sotme. Është huazim libror nga gjuhët romane: it. *blocco*, fr. *bloc*, me burim nga holandishtja *blok* “trung”. Në Veri është marrë nga italishtja, në Jug ka hyrë nga greqishtja (khs. edhe *balkon* e *ballkon*). Si fjalë e re që është, shumësi *bllaqe* është formuar me rrugë analogjike (khs. edhe *stoqe* nga ang. *stock*). Rrjedhoja të fjalës janë: folja *bllokoj* dhe emrat *bllokim* e *bllokues*. Emrin *bllokadë* e ka Leotti.

bóllëz f. “përdheci i parmendës, shpatëza, pjesa e poshtme që ngjitet me dhë”. Fjalë krahinore kryesisht e gegërishtes VL (Malësi e Gjakovës). Rrjedh nga emri *bollë* “gjarpër” me prapashtesë zvogëluese. *Bollëza* është ajo pjesë e parmendës që zvarritet përdhé si bolla. Shënojmë se me emrin “përdhes”, me të cilën quhet bollëza, quhet edhe gjarpri. Një burim nga emri *ballë* (Çabej) nuk ka lidhje të qëndrueshme kuptimore e fonetike. (Çabej SE II 285).

breróre f. “rreth i shkëlqyer përçark një sendi, kurorë e shndritshme, aureolë”. Fjalë e re në gjuhën shqipe. E ka Leotti për “corona di luce”; del

sidomos në përkthime. Është formim i brendshëm nga *për-ar-ore* me kuptimin “rreth i artë, i verdhë”, ku mund të ketë ndikuar *i blertë* për zanoren *-e-* në vend të *-a-së*, ose drejtpërdrejt prej *i blerë* + *-ore* me asimilim të lëngëzores. Edhe në gjuhët romane, it. *aureola*, fr. *aureole*, me të njëjtin kuptim, kanë si burim lat. *aurum* “ar”.

brëshkë f. “kafshë zvarranike, që është e futur në guaskë”. Fjalë e mbarë gjuhës, me burim të paqartë. Dëshmohet së pari në Fjalorin e Bardhit. Morfologjikisht mund të ndahet në *bre-shkë*, formim i brendshëm nga folja *bre-j* “grimcoj, thërrmoj” dhe prapashtesa *-shkë* (khs. *bashkë*, *bjeshkë*), duke u emërtuar si kafshë brejtëse, ku hyn miu, ketri, lepuri etj. Një lidhje me emrin *bretëk* (Stier, Çabej), paraqitet e vështirë nga ana fonetike. Trajtat mashkullore të këtij emri janë: *breshkan*, *breshkor*, *breshk* (Da Lecce) me rrugë prapashkuese (khs. *kunat* ~ *kunatë*) dhe çam. *breshkosh*. Rrjedhoja të fjalës janë: *breshkaman* e *breshkaq* “që ka breshkëza në fyt”, *breshkaz* e *breshkazi* “një lojë fëmijësh” me këtë kuptim edhe rrjedhorja shumë *breshkash*; *breshkëz* “njëfarë mëllëri që del në fyt, një sëmundje e ullirit (Kosovë dhe arb. e Greqisë)” dhe “morr bimësh, lat. *Ceroplastes*”; *breshkore* “mburojë e madhe në trajtë të kurrizit të breshkës”, fjalë e vjetruar; *brezhël* e *brezhëz* “iriqëz, mullâ i zi” (në Spaç të Mirditës), *breshzë* ~ *breshëza* “gogla që dalin ndër bimë si lytha” (Veri), në arbërishten e Italisë *breshkull-a* “gushë, strumë” e *breshkullore* “me strumë”; ndajfola *breshkas* për “një lojë burrash” (Kosovë); kompozitat *breshkamadh* e *breshkaqen* “që ka në fyt gunga të ënjtura”, *breshkujëse* “breshkë uji”. Fjala ka depërtuar edhe në toponimi: *Guri Breshkës* në Elbasan, *Breshkushe* “ara në Kallarat të Kurveleshit”. (Stier nr. 138, Camarda I 104, Meyer EW 47, Weigand Wört. 9, La Piana SLA I 101, Meyer-Lübke REW 1329, Spitzer IF 39, 1921, 105, Çabej SE II 314, Orel AED 36, Luka I 185).

bretk “kryqet, kërbishtet”. Është një nga ato fjalë që kanë dalë thujse nga përdorimi, por ruhet në ndonjë shprehje frazeologjike (*më ra bretku*, *i kalli bretkun*). Fjalë dialektore e toskërishtes me burim të errët. Mund të lidhet me *bretk* “mashkulli i bretkocës” duke marrë parasysh se disa kafshë, si breshka, iriqi, urithi etj. përdoren për të shprehur disa sëmundje në trup të njeriut (khs. *breshkëz*, *irizë*, *byr*, *birth*). Edhe *bretk* përdoret në Kosovë për një sëmundje lopësh, ku edhe *bretkocë* përdoret për të shënuar një pjesë të drunjtë të mullirit që ngjitet për skethin (Zymberi).

bróbull f. “njëlloj ëmbëlsire si petull e vogël”. Fjalë me përdorim të kufizuar në toskërishte, formim i brendshëm nga një rrënjë *bob-*, krijim elementar, që ka marrë prapashtesën *-ull* mbase nga ndikimi i *petull-ës*, duke marrë edhe epentezën e një lëngëzoreje tjetër për të krijuar fjalë me dy

lëngëzore të tilla (khs. *mjegull* ~ *mjergull*, *kuspull* ~ *kruspull*, *tatull* ~ *tartull*). Krijimet elementare për një gjë të vogël, të fryrë e të rrumbullakët, siç është kjo lloj ëmbëlsire, janë në natyrën e shqipes.

brûç m. “njëlloj kandrre, lat. *Melolonta vulgaris*”. Fjalë me përhapje krahinore në gegërishten veriore dhe tek arbëneshët e Dalmacisë, që përdoret edhe si emër familjesh (*Bruçi* e *Brûçaj*). Është formim i brendshëm nga rrënja **brum* (krijim elementar), khs. *brumbull*, me prapashtesën -ç. Karakteri hundor i zanores dëshmon praninë e një sonanteje, që ka rënë për shkak të prapashtesës. Këtë burim e përforcon emri tjetër i kësaj kandrre, *brumaç* (Dema) nga *brum* + -aç. Një burim prej italishtes *bruco* “veme” (Tagliavini, Çabej) ndesh në vështirësi fonetike e kuptimore. Rrjedhojë e fjalës është *brûçak* (në Kelmend) për “brûç i vogël” me kalim kuptimi për “djalë i vogël që duket se s’ka për t’u rritur”, prej kësaj edhe *brûçek* (në Kastrat). Një formim tjetër nga kjo rrënjë është *brûth* me të njëjtin kuptim nga *brum-th* me prapashtesë deminutive. (Tagliavini AD 89, Çabej SE II 331).

brúfull m. “i vogli i qefullit”, me ndryshim kuptimi edhe “shumicë fëmijësh”, “shumicë flokësh (*i ka flokët brufuj*)”, të dala nga kuptimi i parë i fjalës. Është krijim elementar nga një **buf*, zgjeruar me -ull duke marrë një -r-epentetike sipas shembullit të fjalëve me dy lëngëzore të tilla (khs. *mjegull* ~ *mjergull*, *kuspull* ~ *kruspull*, *tatull* ~ *tartull*). Me këtë burim lidhet me *buf* në *fik buf* “i papjekur” dhe *bufkë* në *pulë bufkë* “me xhufkë”. Rrjedhoja të fjalës janë: *brufullon* “del me shumicë, gëlon” dhe “angullin qeni” (Cordignano); *brufullak* “i fryrë, i mbushur e i ngjeshur”, për fëmijë “i shëndetshëm, i shkathët”, së cilës i përgjigjen *bufallak* me të njëjtin kuptim në Elbasan, *brufallaqe* në arbërishten e Italisë me kuptimin “kokërr misri” dhe folja *brufullon* me kuptimin “është plot, zien, gëlon” (*karkalecet brufullojen nd’atë kollomé*). Duke u shpjeguar fjala si krijim elementar nga një trajtë fillestare *buf*, duhet përjashtuar burimi prej ven. *brufolo* “i thatë, çiban”, ashtu edhe një lidhje me pasthirmën *brof* (Çabej), meqenëse -r-ja është shtesë joorganike. (Çabej SE II 332).

brúmbull m. “kandërr me ngjyrë të zezë a të murrme, kacabû i zi, mashkulli i bletës, lat. *Bombus terrestris*”. Fjalë e mbarë gjuhës. Është krijim elementar nga një rrënjë **bum(b)*-, që shpreh diçka të vogël e të rrumbullakët, zgjeruar me -ull duke marrë një -r-epentetike sipas shembullit të fjalëve me dy lëngëzore të tilla (khs. *mjegull* ~ *mjergull*, *kuspull* ~ *kruspull*, *tatull* ~ *tartull*). Këtë etimologji e përforcon emri *brumall* ~ *brumaj* me prapashtesë tjetër për “bletë mashkull” (Kosovë, Nikaj-Mertur). Me këtë burim fjala lidhet përbrenda gjuhës me *bumballë* e *brumaç*. Krijime të tilla kanë edhe gjuhë të tjera, khs. gr. βουμβυλιός “grerëz”, lat. *bombus terrestris* “brumbull”. Një formim

onomatopeik (Meyer, Çabej) nuk është afërmendsh. Rrjedhoja të fjalës janë: *brumullak* (khs. *brufullak*), foljet *brumullin* e *brumullon* “bën zhurmë duke fluturuar (për *brumbullin*)”, *brumullakzot* “*rrumbullakot*” (Bashkimi). *Brumbull* përdoret edhe si ndajfolje për “plot, me majë, buzë më buzë”, duke u nisur nga ajo që *brumbulli* mbledh pleh dhe e bën shuk për ta dërguar në strofull; si rrjedhim, edhe folja *brumbullon* ka edhe kuptimin “mbledh shuk, grumbullon, mbush plot”. Arbërishtja e Italisë ka edhe *brumbullisënj* për “gumëzhin”, *brumbullim* e *brumbullimë* për “gumëzhitje, zukatje”. Fjala përdoret edhe si patronim. (Meyer EW 53, Çabej SE II 333).

brydh fol. “zbut, shkrijoj, shkërmoq”. Më tepër përdoret mbiemri *i brydhët* “i njomë, i butë, i ndulkët, i brishtë, i squllët, i ngathët”. Fjalë e mbarë gjuhës, me burim të errët. Mund të jetë formim me prapashtesën *-dh(ë)* (khs. *shpardh ~ shpardhë*), nga folja *brij* “brej” me kuptimin “thërmoj, shkërmoq, shkrifëroj”; khs. për këtë: *vend i brydh* (Dibër), *të ftohtit e brydh tokën* (Shelcan). Një lidhje me foljen *bredh* “shëtis” (Çabej) nuk vjen afërmendsh. Prej *brydh* janë formuar: *i brydhët* e *i mbrydhët*, *zbrydh*, *cbrydhem* e *zbryth* “ndulk” (Korçë), *i brryllt* “i thyeshëm, i brishtë” (Kelmend) me geminacion ekspresiv dhe me ndikim të *brrylt*-it. Në të gjitha rastet zanorja *-y-* është dytësore dhe e dalë nga *-i-*ja. Duke mos u shpjeguar fonetakisht, ajo mund të ketë dalë nga ndikimi i ndonjë fjale tjetër fonetakisht të ngjashme (khs. *ndrydh*, *shtrydh*). (Çabej SE II 337, Orel AED 38).

buall / búell m. “kafshë shtëpiake me trup të madh e qime të zeza”, f. *buallicë / buellicë*. Fjalë e dy dialekteve; me etimologji të diskutueshme. Dëshmohet së pari te Buzuku: *en deshshit e en buollicashit*. Trajta femërore në anë të Beratit është *buacë*. Kjo mund të jetë formë e shkurtuar e *buallicë-s*, ose e ndërtuar nga forma mashkullore me prapashtesën *-cë* (**buall-cë*). Fjala ka depërtuar edhe në toponimi (*Fushbull* në Elbasan, *Qafbull* në Bulqizë, *Rrashbull* në Durrës, *Sopi i Buacave* në Lushnjë), si edhe në emra fisesh e familjesh, madje në këta shumë herët: (*Gjin Bua Shpata* (1374-1400), *Tanush Bua* (shek. XV), në Moré *Merkur Bua*). Rrjedhojë e fjalës është mbiemri *buallës*, për një lloj fiku (a rrushi), që e ka kokrrën të madhe e të zezë, duke u nisur nga ngjyra e madhësia e buallit. Në Kosovë *bullec* (*bu(e)ll-ec*) përdoret për “fëmijë i trashë nga pamja fizike” (Zymberi).

Për burimin e fjalës, mund të jetë huazuar nga lat. *bove(m)* “ka, lopë”, e cila, me rënien e *-v-së* ndërzanore (khs. sll. *potkova > patkua / patkue*), ka dhënë një **bo*, që hyri në skemën gramatikore të shqipes duke krijuar shumësin **boj*, prej të cilit doli njëjësi **boll* > *buall / buall* (khs. *kaproj ~ kapruall / kapruell*). Prej njëjësit të pashquar janë rindërtuar e shquara *bualli / buelli* dhe shumësi i ri *buaj / buej*. Për këtë rrugë dëshmojnë emrat *nyell* nga *nye* dhe *farizell* (Buzuku) nga *farizé*, që nuk kanë pasur *-ll*, por e kanë marrë

brenda sistemit të shqipes. Supozime të tjera të burimit të fjalës, më pak të mundshme, janë: nga lat. *bubalus* (Stier, Miklosich, Meyer, Pedersen, Meyer-Lübke, Weigand, Skok etj.); ose nga fondi i trashëguar si fjalë vendi, e afërt me gr. βόλινθος “bizon”, isl. vj. *boli*, ags. *bula* “dem” (Çabej). (Stier nr. 43, Miklosich AF II 7, Meyer EW 50, Pedersen KZ 33, 1897, 535, Weigand Wört. 10, Meyer-Lübke REW 1351, Walde-Hofmann I 118, Mihăescu RESEE 1-2, 1966, 13, Haarmann Lat. Lehn. 45, Çabej SE II 339, Orel AED 39).

búbë f. Fjalë me shumë kuptime e rrjedhoja: “vemje e rritur para se të shndërrohet në flutur ose krimb”, “krimb mëndafshi”, “rre, glistër”, lat. *Lumbricus terrestris*; “rrëshqanor që të ha (gjarpër, zhapî etj.)”, “morr i vogël”, “qenie fantastike me të cilën trembnin fëmijët, gogol”, “dordolec” etj. Të gjitha këto fjalë mund të shpjegohen nga një krijim elementar **bub* (Çabej), fonetiki i afërt me *bob*, duke u lidhur fjalët e mësipërme me *bobol*, *bobëz*, *bobël* etj., të gjitha krijime të tilla, fonetiki me dy fonema buzore sikurse *bubë*, duke u përputhur në mjaft raste edhe kuptimet e tyre. Emri *bubë* dëshmohet për herë të parë si emër familjeje, *Lekë Buba*, në Kadastrën e Shkodrës (1416-17). Rrjedhoja të fjalës janë: *bubës* e *bubcë* (geg.) “rre, glistër”, lat. *Ascaris lumbricoides*, në Fjalorin e Da Lecces *bubëzë* “krimb i barkut të njeriut”, *bubaç* e *bubaq* “brumbulli i plehut, lat. *Geotrupes stercorarius*”, *bubajkë* “furrtare, lat. *Blatta orientalis*”, *bubël* (khs. *bobël*) “kokël e vogël e formuar nga fijet ose nga pushi i leshit të ngatërruar”, prej së cilës ka dalë *bublishtë* “tufë karthjesh, bëzhdila”; *bubis* e *bubërroj* (Bashkimi) “qëroj morrat, çmorritem”, duke kaluar folja e fundit prej kuptimit konkret në abstrakt për “bëj punë të vogla, merrem me çikërrima”, “kërkoj për të gjetur diçka, rëmoj”, “shkoj andej-këndeje, sillet e gumëzhin”, “kullot në një vend me pak bar, kërkon ushqim andej-këndeje”, “ngacmoj”, “them diçka nëpër dhëmbë”. Me foljen lidhen emrat *bubërrí* e *bubërrim*. Formime të tjera nga kjo rrënjë janë: *buburoj* (Dibër) “kullot andej e këtej”, *bubrris* (Shpal) “kullot në shkurre”, *buburrec* “kandërr me ngjyrë të zezë, që rron në plehra, lat. *Calosma*, *buburrecë* “milingonë, mizë dheu, lat. *Formica*, *buburezë* “mollëkuqe, xixëllonjë, lat. *Coccinella septempunctata*“, *buburiskë* “xixëllonjë”, *buburizë* “kokërrizë gjalpi që del përsipër kur rrahet qumështi në tundës”, “mollëkuqe, morr i vogël bimësh”; *bubalec* “bubë, dordolec” (për formimin khs. *bishtalec*), arb. e Italisë *bubareshë* “xixillojë” (khs. *trimëreshë*); kompozitat: *bubulesh* “leshtor” me emrin *lesh*, *bubuzhel* “brumbull që rri në plehëra” me emrin *zhele* “lecka”, prej së cilës edhe folja *bubuzhelem* “bëhem me baltë, fliqem”. Prej saj ka dalë edhe *buzhel* “fëmijë i frytë, i majm” dhe “gogol” duke rënë njëra nga rrokjet e njëjta me anë të haplologjisë. Kompozitë tjetër është *bubuzhingë* “vizhë, zhuzhak” me emrin *zhuzhingë*. *Buba* përdoret edhe si patronim. (Stier

nr. 162, Miklosich AF I 353, Meyer EW 50, Skok ER I 223, Meyer-Lübke REW 999, Çabej SE II 340, Luka I 204).

bubullín fol. “gjëmon”. Është fjalë e mbarë gjuhës, me forma të ndryshme nëpër dialekte. Folja *bubullin* me emrin *bubullimë* janë kryesisht të toskërishtes, kurse *bumullon* e *bumullimë* janë të gegërishtes veriore, ku bashkëtingëllorja *-m-* ka qenë epentezë para *-b-*së duke shkaktuar rënie e kësaj të fundit. Forma *brumbulloj* (Kristoforidhi) e Gjirokastrës ka marrë epentezën e një lëngëzoreje. Është fjalë onomatopeike (Meyer), imitim i zhurmës së bubullimës me reduplikacion (*bu-bu*). Dëshmohet më së pari te Buzuku: *u ba endë ças një bonbullimë en qiellit*. Bardhi ka: *Me bumbëlluem, bumbëllimë*. Këto forma janë pararendëset e trajtave të gegërishtes së sotme, *bumullon, bumullimë*. Rrjedhojnë *brumulluer* për “vjeshtë e dytë” e ka Kristoforidhi, si “muaji i bubullimave”. Këtu hyn edhe *bumbulís* “ushton” e arbërishtes së Italisë. Një formë tjetër e kësaj foljeje është në Veri *bumbukatë* (Dema), ku mund të ketë ndikuar *vikatë*. Në këtë grup mund të hyjë edhe *burbujë* “zhurmë” e Veriut (Dema). Fshati *Bubullimë* i Lushnjes dhe pylli *Brumbullimat* e Pogradecit dëshmojnë dëpërtimin e fjalës në toponimi. (Meyer EW 53, Jokl Zb. Beliću 1921, 48, Walde-Pokorny II 107, Walde-Hofmann I 111, Tagliavini AD 90, Çabej SE II 342).

buf mb. “i bëshëm, me faqe të fryra”, *fik buf* “i fryrë”. Është fjalë me burim onomatopeik për një gjë të fryrë, që bën *buf* (khs. edhe *puf, pufe, pufkë*). Rrjedhoja të fjalës janë: *bufë* “hardhi e egër, larushk, lat. *Vitis vinifera*” (Leskovik), *bufe* “mollë kokërrmadhe” (Kërçovë), *bufalaq* “i shëndoshë, bullafiq” (khs. *ngordhalaq*), *bufllon* “gufon” (khs. *ngazëllon*), *bufkë* me disa kuptime, kryesisht në Jug: me kuptimin “xhufkë” në *opinga me bufka, pulë bufkë* “pulë me xhufkë ose me pupla në këmbë”, “dele me shumë lesh në turi”, *bufkë* edhe emri i një luleje “lulebufkë”; me kuptimin “diçka e fryrë, e butë dhe e rrumbullakët” në *bufkë leshi, specia bufkë* “specia të rrumbullakët e të fryrë”, “bluzë grash me mëngë të fryra te supet”; në Veri *bufkë* edhe për “kokërr fryti e pështjellun”. Përdoret edhe si patronim. (Çabej SE II 348).

bufit fol. “mbush gojën me ujë dhe spërkat gjethet e duhanit para se t’i grijë”. Është fjalë me burim onomatopeik nga *buf*, imitim i zhurmës që bëhet kur spërkatet duhani. Prapashtesa *-it* formon folje (khs. *ujit*).

bûj fol. “kaloj natën”. Është fjalë e mbarë gjuhës, që e kanë edhe arbëreshët e Greqisë e të Italisë. Dëshmohet së pari te Buzuku: *e përherë bujtët me tÿ*. Në të folme dialektore del me kuptime të ndryshme: krahas *bûj* “kaloj natën”, në Mëlgushë (Shkodër) *bujë* “kasolla e pulave”, në ishullin Poros (arb. e Greqisë) *ujë të bujturë* “të ndenjtur”, që i përgjigjet toskërishtes *lakër e bujtur*, në Qeparó e *bujtura* “vendi ku flenë dhitë”, në Çamëri *shkoi*

nusja në të bujtur “në gjini, te prindët”, fig. *shtëpi e bujtur* “nikoqire” e *njeri i bujtur* “i matur” etj. Me këtë folje lidhet edhe emri *bun* “kasolle stanarësh në bjeshkë”. Është fjalë e trashëguar, që lidhet me rrënjën *b^heu-*, me shumë kuptime e zhvillime në gjuhë të ndryshme, origjinarisht “rrit”, got. *bauan* “banoj”, lit. *būti* “jam”, sll. vj. kisht. *byti* “bëhem, jam” (Meyer). Sonantja *-n-*, që ka rënë duke hundorëzuar zanoren, mund të jetë mbaresa e trashëguar e rasës kallëzore. Një lidhje me sll. *buditi* “zgjoj”, lit. *būdeti* “rri zgjuar” (Çabej) qëndron larg burimit, si nga kuptimi, ashtu edhe nga forma. Neologjizma të formuara nga folja janë: *bujtje*, *bujtës*, *bujtar*, *bujtari*, *bujtësi*, *bujtinë* e *bujtore* “hotel”, *bujtinar* “pronar bujtine”, *i bujtshëm* “mikpritës”. Prej shqipes fjala ka depërtuar edhe në disa të folme serbe. (Bugge BB XVIII 1891, 163, Meyer EW 51, Brugmann Gr. I² 106, Boisacq 1043, Walde-Pokorny II 140, Walde-Hofmann I 558, Çabej SE II 351, Demiraj 111, Orel AED 39, S. Hoxha 63).

bújgër m. “lloj qarri, qarr i kuq, bungëkeqja, lat. *Quercus macedonica*”. Fjalë me përhapje krahinore në të dy dialektet dhe me forma të ndryshme: *bujgër* (Tomor, Përmet), *bulgër* (Vlorë), *bulgrak* nga *bulgër* (Kthellë - Mirditë), *bugjër* (Dumré, Kërrabë, Skrapar), *bugë* e *bujk* (Kolonjë). Nga të gjitha këto, forma bazë është *bulgër*, që etimologjikisht shkon me *bung* “shpardh”; khs. edhe *bungëkeqja* për bujgrin. Fonetikisht, *bung* ka marrë epentezën e një *-n-*je, meqenëse lidhet me gr. φαγός “lis”, lat. *fagus* e gjerm. l. vj. *buohha* “ah”; kurse *bulgër* ka marrë prapashtesën *-r* (khs. *shtogër*) dhe epentezën e lëngëzores tjetër për të krijuar fjalë me dy lëngëzore sipas rasteve të ngjashme (khs. *blushtër* nga *bush tër*). Kësisoj, të dyja fjalët kanë pasur rrënjën *bug-*, që mori dy rrugë zhvillimi: në njërin anë *buⁿg* e në anën tjetër *bu^lg-ër*. Emri ka depërtuar edhe në toponimi: *Bulgër* në Mirditë, që dëshmohet më së pari në Kuvendin e Arbënit. (Çabej SE II 355, Topalli Sist. bashk. 96).

bukós fol. “zë me leckë a me shtupë një vrimë, bllokohem, më zihet goja”. Fjalë e dialektit toskë, huazim nga gr. re μπουκώσα, aoristi i foljes μπουκώνω “mbush gojën, bllokohem”. Përhapja e fjalës në Jug pajtohet me burimin e saj.

bulb m. “koka e kërcellit të disa bimëve, si qepa etj., që rri nën tokë”. Fjalë e re në gjuhën shqipe, huazim nga it. *bulbo*, kjo me origjinë nga gr. βολβός (krijim elementar). Rrjedhoja të fjalës janë: mbiemri *bulbe* (*dardhë bulbe* “me kokrra të mëdha e me tul”) e *bulbor*, folja *bulbëroj* “del me shumicë, buis, gëlon”, prej së cilës janë formuar mbiemri *i bulbërt* “i begatshëm” dhe emrat *bulbëri* e *bulbërim* “begati, pasuri, shumicë”.

bulçí sh. “ana e brendshme e faqes, nga goja deri te veshët”. Fjalë që përdoret vetëm si shumë duke u nisur nga dy faqet. Forma *bulçí* është e toskërishtes, që ka edhe *bullçim* (Tase), ndërsa gegërishtja ka formën *bulshí*, të

cilën e ka edhe arbërishtja e Greqisë. Këto forma janë formuar në shumës me formantin *-inj*, që merr mbi vete theksin e fjalës; si rrjedhim, forma bazë është *bulç / bulsh*. Kjo ekziston tek emri *bulç* “bark” (*muri lshoi bulç*) në Bregun e Detit (Sarandë). Lidhet edhe me *bulçarak* (*fik bulçarak*) “njëlloj fiku kokërrmadh”, me *bulçik* “bullafiq” (Godin), *i bulçikët* “i ndylkur, i pjekur shumë”, *me u bulçikë* “me u ajë”. Sipas Çabejt më tej mbetet e paqartë. Fjala mund të analizohet më tej në *bul-ç* e *bul-sh*, ku *-ç* e *-sh* janë prapashtesa (khs. *gulç* e *gulsh*); kurse rrënja e fjalës, meqenëse në të gjitha rastet kemi idenë e diçkaje të fryrë, mund të jetë një krijim elementar, një **bubul* (khs. *bobol*), që është thjeshtuar në *bul-* me anë të haplogjisë. Rrënja *bul-* mund të jetë edhe formim onomatopeik si imitim i tingullit që bëhet kur shfryhet diçka. Gjithsesi fjala është formim i brendshëm i shqipes. (Meyer EW 52, Skok ER I 223, Çabej SE II 362, Luka I 216).

bulë f. Fjalë me shumë kuptime: “sythi i bimës, mugull”, “pikë (uji, shiu, djerse, loti)”, “flluskë e vogël (*bulë ajri*)”, “pjesa e tultë e veshit (*bula e veshit*)”, “lungë e rumbullakët dhe e fryrë, puçërr e madhe”, “pjesë e disa frutave (*bulë shege*). Fjalë me burim të diskutueshëm. Është kryesisht e gegërishtes, por është bërë e mbarë gjuhës. Mund të jetë huazim nga lat. *bulla* “bulë uji, sumbull, kopsë” (Meyer), me të cilën pajtohet fonetakisht e kuptimisht. Një burim tjetër mund të jetë përbrenda shqipes nga një rrënjë **bul-*, krijim elementar për diçka të fryrë si flluskë, duke u afruar me *bulç* e *bulkth*. Rrjedhoja të fjalës janë: *bulëz* “një pikë ujë”, *bulon* e *bulim*, *bulëzon* e *bulëzim*, në Lurë *bulson* “rrjedh uji”, në Sulovë *bulit* “pi pika-pika, gjerb”, *me bulçelë* (geg.) “me bulue”. (Meyer EW 53, Pedersen KZ 33, 1897, 536, Jokl IF 44, 1926, 56, La Piana AN V 1957, 15, Mihăescu RĚSEE 1-2, 1966, 13, Schmidt KZ 50, 1922, 236, Mann Lg. 26, 1950, 387, Çabej SE II 362, Orel AED 41, Luka I 217).

bulkth m. “kandërr e vogël si karkalec, që rron në vrimat e dheut a të mureve të vjetra dhe nxjerr një zë si të gjinkallës, lat. *Gryllus domesticus*”. Fjalë me përhapje krahinore në të dy dialektet dhe me forma të ndryshme: *bulk* e *bulkth*, *bujk* e *burkth*; me burim të diskutueshëm. Analiza e këtyre formave të çon në përfundimin se kemi krijime me prapashtesën *-th* deminutive nga një rrënjë *bulk* a *burk*, edhe këto me prapashtesën *-k* nga rrënjët *bul-*, *bur-*, krijime elementare nga *bub-ul* e *bub-ur*, që kanë shërbyer për formimin e shumë fjalëve të tilla, si: *bubël*, *bublishtë*, *bubërroj*, *buburrec*, *buburezë*, *buburiskë*, *buburizë*, *burth* “një lloj bime me zhardhok, lat. *Cyclamen europaeum* (Kelmend) dhe “sëmundje që i bie gomarit me ënjtje të gojës” (Kërrabë), *zburth* “njëlloj kërpudhe” etj. Një burim tjetër mund të jenë formimet onomatopeike me *bul-* e *bur-* (khs. *buluron* e *bulurit*, *bërlyket* e *barrirroj*) duke marrë parasysh se bulku është një kandërr që nxjerr zëra vazhdimisht natën.

Një lidhje me emrin *bujk* (Çabej) qëndron larg si nga ana kuptimore, ashtu edhe nga ana fonetike, ku grupi *-lk-* duhet të ishte kthyer gjithandej në *-jk-* (vetëm në Seman *bujk*). (Stier nr. 167, Camarda II 145, Meyer EW 55, Tagliavini Strat. 133, Çabej SE II 384).

bulmët m. “qumështi dhe prodhimet që nxirren prej tij: gjalpë, djathë, gjizë, kos”. Fjalë e dy dialekteve me forma të ndryshme nëpër të folme dialektore, sot e mbarë gjuhës. Dëshmohet së pari te Budi: *o mbë voj, o mbë bulmet* (SC). Me të njëjtën formë te Bogdani e Kuvendi i Arbënit. Bogdani ka edhe foljen *përbulmet*. Për hetimin e burimit të saj është e nevojshme të shqyrtohen format e shumta dialektore bashkë me rrjedhojat e tyre, sidomos foljet me të cilat lidhet emri. Ndër to vëmë në dukje: *bulmej, bulmyej, bylmej ~ bylmye* “i shtie gjellës yndyrë”, *bulmetë* e *bulmetur* (nga *bulmet*), *i bylmyeshëm, bulmuaj, mëlmej* “i shtie gjellës yndyrë”, *me melmye* “ha prodhime qumështi”, *i mëlmyeshëm, përbules* “mëlmej”, *burbulet* “i prish dikujt kreshmët”, *përmëles* “i prish kreshmët”. Nga krahasimi i këtyre formave rrjedh se *bulmet* e *mëlmyej* kanë një rrënjë të vetme, nga të cilat ajo me *m-* është parësore, kurse ajo me *b-* është dytësore dhe e dalë prej saj në fjalë me një lëngëzore me kalimin: *mel-* > *m^bel-* > *bel-* (khs. *mjaltë* e *bletë, miell* e *bluaj*). Duke marrë parasysh se lyra trajtohet shpesh si ndotje (khs. *lerë* e *lyrë, i lyrët* “i ndotur, i fëlliqur”), rrënja e fjalës lidhet me rrënjën ie. *mel-* “emërtim ngjyrash, sidomos për ngjyra të errëta, i papastër, i ndytë”, nga e cila kanë dalë ind. vj. *maliná* “i ndytë, i zi”, gr. μέλας “i zi”, lat. *mulleus* “i kuqrremtë”, të cilave shqipja u përgjigjet me *mëllënjë*. Tek *bulmet* e *melmyej* duket qartë prapashtesa *-m*, që ka ruajtur lëngëzoren *-l-* (khs. *pjalm*); tek *bulmet* del edhe prapashtesa tjetër *-et*. Një lidhje me foljen *lyej* (Çabej) shkon nga ana kuptimore, por jo edhe nga ana fonetike. Rrjedhoja të fjalës janë: *bulmetor* “që ka të bëjë me bulmetin” e *bulmetore* “punishte a dyqan bulmeti”. (Meyer EW 53, 58, Skok ER I 136, Çabej SE II 364).

bullungë f. “xhungë në trup a në kokë, gungë në trup të drurëve”. Është fjalë krahinore e gegërishtes, e përgjithësuar në gjuhë, me burim të errët. Dëshmohet edhe me forma të tjera, si: *mllungë* (Malësi e Madhe), *mbullungë, mbëllungë* e *mbollungë* (Kristoforidhi), *bllungë* me kuptimin “shtëllungë leshi” (Logoreci). Në të gjitha këto kemi formime me prapashtesën *-ungë*, nga një rrënjë *bull-* a *mull-*. Cila nga këto dy rrënjë është parësore, përcakton edhe burimin e fjalës. Nëse parësore është *bullungë*, kjo lidhet përbrenda gjuhës me *bullafiq*, si një krijim elementar me një buzore e një lëngëzore; ndërsa, në qoftë se parësore është *mbullungë*, atëherë *-b-*ja është një epentezë dhe fjala lidhet përbrenda gjuhës me *mullë*, që ka formuar, nga njëra anë *mullâ-ni* / *mullë-ri*, nga ana tjetër *m^bullungë* > *bullungë* (khs. *miell* e *bluaj, mjaltë* e *bletë*). (Meyer

EW 53, Schmidt KZ 50, 1922, 236, Jokl RIÉB 3-4, 1936, 76, La Piana AN V 1957, 15, Çabej SE II 368, Orel AED 41, Luka I 222).

burbuléc m. “krimb që rritet nën lëkurën e disa kafshëve ose në ujë të ndenjtur”. Fjalë kryesisht e dialektit toskë dhe e Shqipërisë së Mesme. Është formim i brendshëm i gjuhës me prapashtesën *-ec* nga një temë **burbul*, vetë kjo nga *bu’b-ul*, krijim elementar (khs. *bubë*), që ka marrë epentezën e një *-r*-je duke krijuar fjalë me dy lëngëzore (khs. *borbolec* < *bo’bol-ec*). Me këtë mënyrë është formuar edhe emri i një kandrrë tjetër, *burbulicë* “mollëkuqe, lat. *Coccinella septempunctata*”, që ka marrë prapashtesën *-icë*.

burg m. Fjalë me shumë kuptime. Përdoret për “ndërtesë ku mbahen ata që janë dënuar me heqje të lirisë”, “qilar ku ruhen ushqime e pije”, “haur bagëtish”, “errësirë e madhe”, “kodër e vogël, shkëmb i thepisur”, “varr”. Fjalë e mbarë gjuhës, që dëshmohet për herë të parë te Buzuku: *e shtiu endë burg*. Ky autor ka edhe rrjedhjen *burgëtar* për “i burgosur”. Nga të gjitha kuptimet e fjalës, më i hershëm duket ai i një vendi ku mbahen të burgosurit, që lidhet me lat. *burgus*, e cila ka pasur kuptimin “kështjellë”, prej saj edhe “qytet i vogël, lagje periferike” (khs. it. *borgo*). Dihet se burgjet mesjetare kanë qenë brenda kështjellave, të cilat ndërtoheshin gjithnjë majë kodrave. Prandaj nga *burg* “vendi i nëndheshëm i kështjellës ku mbahen të burgosurit” rrjedhin kuptimet “qilar”, “haur”, “errësirë”, “varr”; ndërsa nga “kështjellë majë kodrës” rrjedhin “kodër”, “shkëmb”, “shpellë”, që dalin sidomos në toponiminë e Shqipërisë së Veriut: *Krepi i Burgut*, *Burgu Gurajt*, *Burgu Vrihit*, *Burgu i Lugjeve*, *Burgu i Ferrës*, *Burgjës*; kompozitat *Suka e Burgakeqit*, *Burgdobërçet*, *Burgkrymbëça* etj.; kurse emri i fshatit *Burgajet* (Mat) është *burg-ajë-et*, me dy prapashtesa (khs. *dushkajë*). Përdoret edhe si emër familjeje (*Burgaj*). Një formë shumësi e singularizuar është *burgj* e Tetovës, që përdoret për “errët, terr”. Një burim vendës, duke e krahasuar fjalën e shqipes me gjerm. *bergen* “fsheh”, rus. *beregù* “kursej, ruaj” (Çabej) nuk ka gjasa. Rrjedhoja të fjalës janë: *burgoj* e *burgim*, *burgos* e *burgosje*, *burgëtoj*, *burgtar* “i mjerë, i shkretë” (Bashkimi). (Stier nr. 167, Miklosich AF II 7, Helbig 43, Meyer EW 54, Jokl X 1934, 183, Çabej SE II 379, Orel AED 42).

burón / bunón fol. “del ujë prej toke, zë fill një rrjedhë uji”. Është fjalë e mbarë gjuhës, që është përgjithësuar me trajtën e toskërishtes, kurse forma gege ka mbetur në përdorim dialektor. Dëshmohet për herë të parë te Bogdani: *kruet’ e kahë bunon*. Në Fjalorin e Da Lecces *me bonuem* “scaturire”. Rrjedhoja të fjalës janë: *burim* e *burues* të mbarë gjuhës, *buromë*, *buronjë* e *burishtë* dialektore të Jugut. Ka depërtuar edhe në toponimi: *Buronjë* në Kuç të Kurveleshit, *Burimi i Plakës* në Korçë, *Burimi i Qershizës* në Skrapar etj.

Etimologjia e fjalës është e errët. Shpjegimet do të nisen nga një **bun*, që ka krijuar foljen *bunoj*, ndërsa forma toske *buroj* paraqet formën e zhvilluar me rotacizëm. Mund të lidhet me rrënjën **bun*, nga e cila ka dalë folja *bûj*, e cila në *ujë të bujtur* ka kuptimin “i ndenjur”, ashtu si përdoren *amë* e *amull*, e para për “burim”, kurse e dyta për “ujë të ndenjur”. (Camarda I 60, Meyer EW 478, Vasmer Wort. 8, Çabej SE II 386).

burth “bimë barishtore me gjethe si zemër e me lule të trëndafilta, ciklamin i egër, lat. *Cyclamen europaeum*”. Është fjalë krahinore e gegërishtes veriore (Kelmend), që njihet edhe si *zburth*. Në të dyja rastet kemi formime me prapashtesën zvogëluese *-th* nga një rrënjë *bur-*, e shpeshtë në krijime elementare për lule e kandrra. Me këtë burim emri i kësaj bime afrohet fonetikisht me *burbuqe*, *burbull* (lat. *Cotoneaster integerrima*), *burth* “sëmundje që i bie gomarit me ënjtje të gojës” (Kërrabë), *burkth* (lat. *Gryllus domesticus*), *zburth* “njëlloj kërpudhe” etj. Përdoret figurshëm edhe për “mëllef, inat”. Një lidhje me *burg* “vendi ku ruhen ata që janë të dënuar” (Çabej), nuk qëndron nga ana kuptimore. (Çabej SE II 387).

bushiq mb., m. Si mbiemër “i fryrë, i mbushur, bullafiq”, si emër “fluskë, fshikë”, në Malësi të Madhe “balonë që mbushet me frymë”. Fjalë me burim të diskutueshëm. Mund të jetë formim i brendshëm nga (*m*)*bush* me prapashtesën *-iq* (Çabej). Një burim tjetër mund të jetë nga *bulsh* + *-iq* me rënie të lëngzores duke u lidhur me *bush* ~ *bulç* e *bulçí* ~ *bulshí*, forma e plotë e së cilës ruhet në Pukë te *bulshiq* “i shëndoshë, buçko”. Një formim tjetër i këtij lloji është *bushak* me prapashtesë tjetër, që përdoret edhe si patronim. Arbërishtja e Italisë ka *i bushëm* për “i mbushur nga trupi”. Në këtë grup hyn edhe *bushliqe* “fshikëz që del në lëkurë nga të djegurit, fulltakë” (Kavajë), formim me prapashtesën *-iqe* duke u ndikuar nga fjalët me *-liqe* (*pushkaliqe*). Fjalori i Bashkimit ka edhe *bushikzë* për “fshikëza e urinës”. Leotti ka *bushikë* për “fluskë uji, fshikë”. (Çabej SE II 394, Luka I 233).

buzhél mb. “i shëndoshë, bushiq, bullafiq”. Fjalë dialektore e gegërishtes (Bashkimi). Formim i brendshëm i gjuhës, që lidhet me *bushiq* e *bushak* “i fryrë, i mbushur” dhe kanë si rrënjë foljen (*m*)*bush* duke marrë prapashtesa të ndryshme (**bush-el*). Me *buzhel* lidhet emri *buzhelë* “fluskë që del zakonisht në buzë nga ethet ose djegiet”, duke u përdorur me një kuptim të dytë ashtu si përdoret mbiemri *bushiq* me kuptimin “fluskë, fshikë”.

byc m. “puçërr me qelb, elbth”. Fjalë krahinore, por me shtrirje në të dy dialektet. Trajta më e hershme ka qenë *bic*, kurse *byc* ka dalë me asimilim të zanores nga bashkëtingëllorja. Përdoret edhe për “bisk i vogël që sa ka filluar të dalë nga toka”, duke u lidhur me *bisk*, në analizë të fundit me foljen *bij*, si diçka që ka mbirë, degëz, bisk, që ka marrë prapashtesën *-c*. Nga një

burim tjetër mund të jetë një krijim elementar (khs. *puc* e *puçërr*). Në disa të folme mund të jetë përzier me *bri* (*brryc* në Krujë, *bri* në Vlorë). Një lidhje me *bic* “derr” (Çabej) ka gjasa të pakta.

C

cabók m. “stom, naltësinë e vogël”. Fjalë me përhapje krahinore në gegërishten veriore (Gazulli). Lidhet me *bokë* “kodër e vogël, bregore”, që ka marrë parashtesën *ca-* (khs. *camurr* “qen i murrët”). Një burim nga *kërçabë* “kular në trajtë trekëndëshi me thepa, që u vihet derrave në qafë për të mos kaluar gardhin” ose nga *çapok* “kërciri i këmbës, kërdhokull” (Çabej) nuk kanë mbështetje kuptimore. (Çabej SE III 4).

call mb. “i papjekur, *fik call*”. Fjalë krahinore e toskërishtes (Labëri). Është një formë *allegro*, shkurtim i mbiemrit *callangur*, vetë kjo një shqiptim krahinor i mbiemrit *skallangur* i atij dialekti, që përdoret për “i papjekur, i pabërë” dhe me kuptim konkret për “kombisht”.

camërdhók m. “fëmijë i vogël, vocërrak”. Është fjalë e gegërishtes veriore, që ka edhe një trajtë më të thjeshtë, *mërdhok*, prej së cilës ka dalë mbiemri *i mërdhoqët* “i stërkequn, i pashëndet” duke u nisur nga kuptimi “i vogël, i pazhvilluar”. Te *camërdhok* kemi formim me parashtesën *ca-* nga *mërdhok* “guriç, gur i vogël”, që lidhet përbrenda gjuhës me *papërdhok* “guralec, gur i vogël”. Kalimi kuptimor është bërë duke u mbështetur në “gjë e vogël”, pastaj “fëmijë”; khs. *çikë* “copë e vogël, grimë” e “vajzë”. Te *mbërdhok* nga *papërdhok* ka rënë rrokja e ballit me anë të haplologjisë dhe është shtuar një *m-* protetike.

Nga një cungim i fjalës kanë dalë *cam* e *camër*. E para përdoret me kuptimin “i ri” (Lukaj), prej së cilës kanë dalë emrat e familjeve *Cami* (Dibër) e *Camaj* (Dukagjin). E dyta ka krijuar emrin *camërlík* për bimën “arçi i alpeve, lat. *Rhamnus alpine*” e për zogun “cinxami” lat. *Troglodytes troglodytes*, që del edhe si *camërli*. Në Bizë të Ishmit *camerlik* është një peshk i vogël. Një krijim tjetër nga shkurtimi *camër* është *camrruk* me prapashtesën *-uk*, që përdoret me kuptimin “thelb, gështenjë e qëruar”, kurse si folje *camrukem* “mblidhem, strukem, gërmuqem”.

Shpjegimi i Çabejt për këtë fjalë, që merr si pikënisje emrin *callok*, ka vështirësi fonetike për shpjegimin e trupit të fjalës dhe të rrjedhojave të saj. (Gazulli 18, Çabej SE III 8, Orel AED 45).

cërcëré fol. “skuq në tigan”. Fjalë krahinore e toskërishtes. Folje e krijuar me prapashtesën *-et* nga një bazë onomatopeike me reduplikacion, si imitim i kërcitjes së vajit kur skuqet diçka në tigan (*cër-cër*). Forma të tjera të

kësaj foljeje, më të thjeshta, janë *cërij* e *cërit*, e dyta edhe me kuptimin “derdhet pak nga pak një lëng”, si imitim i tingullit të ujit kur derdhet (*cërrr*).

cërrán “rrem a vijë uji shumë e vogël”. Fjalë krahinore e dialektit gegë (Gazulli). Është formim i brendshëm i shqipes me prapashtesën *-an* nga një rrënjë **cërr* me bazë onomatopeike, si imitim i zhurmës që bën uji kur rrjedh. Tropoja e ka me formën *cërramë*. Lidhet përbrenda gjuhës me *curril*, që ka të njëjtën bazë onomatopeike, por ka marrë prapashtesë tjetër. Një fjalë tjetër që lidhet me *cërran* është *cërrkaç* nga e njëjta rrënjë e me të njëjtin kuptim, që ka marrë prapashtesat *-k + -aç*; kurse *cërrlik* “curril uji” ka dalë drejtpërdrejt nga *curril* me prapashtesën *-ik*.

cërrfát fol. “shkrep zjarrin”. Fjalë krahinore e gegërishtes (Pukë), e krijuar me prapashtesën *-at* nga një bazë onomatopeike **cërrf*, si imitim i krismës që bën zjarri kur ndizet. Nga kjo bazë me prapashtesë tjetër është krijuar edhe folja *cërrfos* me të njëjtin kuptim. Foljet e mësipërme kanë krijuar emrat *cërrfatje* e *cërrfosje*.

cërrlë f. “purthë, lëbarke”. Fjalë krahinore e toskërishtes (Vlorë, Gjirokastër, Çamëri), e krijuar me prapashtesën *-lë* nga një bazë onomatopeike **cërr*, si imitim i zhurmës që bën purtha kur del jashtë. Kësisoj, përbrenda gjuhës lidhet me *curril* e *cërron*, që kanë marrë prapashtesa të tjera. Më afër saj qëndron fonetikisht *cërrlik* për “curril uji”.

cërrón fol. “rrjedh pak nga pak, del si curril”. Fjalë krahinore e toskërishtes (Skrapar, Korçë), e krijuar me prapashtesën *-o* të foljeve nga një bazë onomatopeike **cërr*, si imitim i zhurmës që bën uji kur rrjedh. Kësisoj, përbrenda gjuhës lidhet me *curril* e *cërrlë*, që kanë marrë prapashtesa të tjera.

cíli p. Trajta femërore *cila*. Shumësi *cilët ~ cilat*. Përemër pyetës e lidhor, që dallohen nga njëri-tjetri prej përdorimit të nyjës së përparme. Është formim i brendshëm i shqipes relativisht i vonë, që nuk e ka pasur gjuha popullore, e cila njihet përmes *kush* (pyetës) dhe *që* (lidhor). Mungon edhe në arbërishten popullore të Italisë e Greqisë dhe ka depërtuar vonë te ndonjë shkrimtar. Dëshmohet së pari te Buzuku, që e përdor me nyjë edhe kur është përemër pyetës: *Të sillë doni en së dysh u t u lëshonj?* Del rregullisht tek autorët e tjerë; Matrënga: *cili ishtë i treti shërbes*; Budi: *e cia për gjithë ditë po nçtohetë e përtërihetë* (DC); Bardhi: *pā të sijët askush s munë shërbenjë si duhetë*.

Nga përdorimi i këtij përemri te Buzuku edhe si pyetës shihet se nyja ka qenë pjesë përbërëse e këtij përemri. Prandaj, jo përemri lidhor *i cili* është pajisur me nyjë, por nyja, që ka qenë e pranishme te ky përemër, e ka humbur funksionin e vet dhe ka rënë kur është përdorur si përemër pyetës. Kjo do të

thotë se ky përemër është formuar në krye të herës si përemër lidhor dhe më vonë është përdorur edhe si pyetës duke humbur edhe nyjën e përparme. Ai është formuar nga ndajfolja përemërore *si* në formën e shumësit *të sij*, që e kanë autorët e vjetër, ku me bashkimin e nyjës me përemrin doli forma *cij* duke u përsëritur nyja për hir të plotësisimit të skemës nga kishte dalë. Forma e sotme me *-l-* ka dalë nga forma me *-ll-*, që e ka gegërishtja VP (*cilli*), dhe vetë kjo nga shumësi *cij* sipas skemës së shumësit (khs. *hell* ~ *hej*). Forma të tjera të këtij përemri nëpër dialekte janë: *cijë* (me mbaresën e femërorëve në analogji me *bijë*), *ciu* (me rënien e *-j-së* fundore dhe shtesën e nyjës *-u*), *cir-i* (në analogji me *bir-i* ~ *bij*).

Formime nga ky përemër janë: përemrat *cilido* ~ *cilado* (me folje në vetën III njëjës), *secili* ~ *secila*, *akëcili* ~ *akëcila*, *gjithsecili* ~ *gjithsecila*. Emri *cilësi* është neologjizëm bashkë me rrjedhojat *cilësoj*, *cilësim*, *cilësisht*, *cilësor*, *cilësues*, *cilësorisht*. (Meyer EW 383, Pedersen AT 20, Weigand Wört. 71, Çabej SE III 35, Orel AED 46, Topalli Për. 164).

cimb fol. “pickoj, thumboj”. Fjalë me përhapje krahinore kryesisht në toskërishte, jo e panjohur në gegërishte. Lidhet përbrenda shqipes me *thim-th* e *thim-c* “thumbi i arzës a i bletës” dhe “maja e boshtit të rrotës”, me ndërrimin *c- : th-*. Duke u nisur nga kuptimi “ther, shpon”, përbrenda gjuhës lidhet edhe me *cëmon*, *sëmbon* e *cimbon* “më ther, më dhemb”, me *cëmat* e *thumat* “pykë e vogël, hell i hollë për të qepur lëkurë, rripa, thasë etj.”, ku është i njëjti raport *c- : th-*. Me një tjetër shkallë vokalike lidhet edhe me *thumb* : ie. *kom-* “shtagë”, ku bën pjesë ind. vj. *çamyā* “shkop, hell, gozhdë druri, kunj”, gr. κάμαξ “shtagë, hu”. Me foljen lidhet emri *cimb* për “pickim, thumbim”, “grep i vogël për të qëndisur”, “sqep”, “piskërr”. Rrjedhoja të fjalës janë: folja *cimbis* “pickoj” (rrj. *cimbisje*), ndajfolja *cimbthi* “pisk”, emrat *cimak* (*cmak*, *cmag*) “gozhdë e drunjtë, kunj”, “briri i insekteve”, *cimel* “thumb, thimthi i bletës” e “mugulli që qet për herë të parë fara e mbjellë”, me përhapje krahinore në toskërishten JL (Kolonjë, Dangëlli), të formuara me prapashtesat *-ak*, *-el*. Në Veri *cimël* ~ *cimla* “pipa të hollë të njomë a të thatë” (Dema). Rrjedhoja të tjera janë: *cimar* “pjesë e vegjës me dy rripa metali të dhëmbëzuar anash”, me prapashtesën *-ar* dhe *cimbil* “bodec, bizë” me prapashtesën *-il* (khs. *curril*), arb. e Italisë *cimblor* “therës, ngacmues”. Kuptimi “mugull, degëz” i *cimak*-ut del edhe në disa rrjedhoja të tjera që bëjnë pjesë në këtë çerdhe fjalësh: *cimël* e gegërishtes veriore për “pipa të hollë, të njomë e të thatë”, *cimbël* “cifël, bisk, fundçe duhani” dhe emri i një bime, lat. *Salsola soda*, që i ka gjethet me majë; *cimbull* (Libohovë) për “degëz e vogël, gem”. (Çabej SE III 39, 51, Orel AED 47).

cimbúr m. “parazit i vogël, që u ngjitet kafshëve në lëkurë e u thith gjakun, këpushë, rriqër, lat. *Tetranychus ulmi*”. Fjalë krahinore kryesisht e

toskërishtes (Vlorë), jo e panjohur në gegërishte (Durrës), te Dema “rriqen”. Përmban rrënjën **cimb* me kuptimin “pickoj, thumboj” (khs. *cimbis* e *cimbon* “ther, shpon”), meqenëse parazitë të tillë pickojnë kafshët për t’u thithur gjakun. Prapashtesa *-ur* mund të jetë e shumësit (khs. *zermurë*) duke qenë fjala një shumës i singularizuar.

cing pasth. Përdoret në shprehjet: *s’bëri cing me gojë; as cing as, ming*; në shumës: *cingra-mingra*. Është fjalë onomatopeike, kurse *ming* është krijim që bën rimë me *cing*. Rrjedhojë është *cingthi* për “mënyrë të ecuri me njëren këmbë” me prapashtesën *-thi*, që formon ndajfolje. Shumësi *cingra-mingra* është i toskërishtes me formantin *-ra*. *Cing* përdoret edhe për “tringëllimë”, prej së cilës është krijuar folja *cingëllon* “nxjerr një tingull të hollë, tringëllon” (rrj. *cingëllimë*).

Nga kjo rrënjë është formuar emri *cingare* për “zile bagëtish”, fjalë me përhapje krahinore në gegërishte (Dukagjin, Lumë etj.), që ka marrë prapashtesën *-are*. Me këtë burim, fjala është e afërt me *cigremë* e *cingremë* “zile e madhe” dhe me foljen *cingron* “kuis, pingëron” (rrj. *cingërimë*). Këtyre u përgjigjen në Jug *cingërlaqe* “zile e vogël” (Libohovë) me prapashtesat *-lë + -aqe* dhe *cingëliqe* (Skrapar). Në Has *cingelinge* “cingare vjetash, kumbonë viçash”, në Gostivar *cingël* “zile”, në Malësi të Tetovës *cingët* e *cingllon* “qan pa lot me zë të ulët”. Në këtë çerdhe fjalësh hyn edhe *cingonë* e gegërishtes (Bashkimi) për “gajde, pipëz, curle” me prapashtesën *-onë* (khs. *zefonë*) dhe me ndikim të *kumbonë-s*, si edhe *cingëlimë* për “cingare, zile”. (Çabej SE III 41).

cingla f. sh. “sende të vogla prej metali, që varen si stoli, xhingla”, “çikërrimë, vogëlsirë”. Fjalë krahinore e gegërishtes (Tropojë etj.). Është formim i brendshëm me prapashtesën *-lë* nga një bazë onomatopeike **cing*, si imitim i tingullit që lëshojnë sendet prej metali kur përplasen me njëra-tjetrën. Një formë tjetër e kësaj fjale është *xhingla* (nga *xhing-xhing*, khs. *rringi-xhinge*). Rrjedhoja të *cingla-ve* janë: *cingëloj* “zbukuroj me xhingla”, *cingëlane* “grua që stoliset me xhingla”, *cingëlatore* “grua që stolis nuset”, *cingëlore* “varg me cingla e stoli të ndryshme që mbahen në qafë” dhe “dyqan ku shiteshin xhinglat”. Kuptimi “sende të vogla” (khs. *cingra-mingra* dhe *xhingra-mingra*) del në *cingëlar* “çikërrimtar”. Një tjetër fjalë me këtë kuptim mund të jetë *cingël* “fik kokërrvogël me rrudha”, që ka sinonimin *cingull* “fik i bardhë me kokra të vogla” me prapashtesë tjetër.

cirë f. “lëvorja e drurit”, “dru i qëruar nga degët, trung pa degë”. Kuptimi i saj i parë ka qenë “lëkurë”, që del te “lëvorja e drurit”, khs. në *cirë* “zhveshur, lakuriq” domethënë “lëkurë”. Meqenëse në shumë gjuhë kuptimi i lëkurës jepet me folje që kanë kuptimin “pres, ndaj” (khs. *lëkurë* : ie. *kor-*

“pres, ndaj”, gr. κείρω “pres”, lat. *corium* “lëkurë”), *cirë* lidhet përbrenda gjuhës me *cërrit* dhe të dyja këto me foljen *ther*, duke u shpjeguar me sistemin fonetik të shqipes me shndërrimin *c- : th-*.

ciripúpe f. “zog me pendë të murrme, që ecën duke kërcyer, lat. *Saxicula rubetra*”. Fjalë e dialektit gegë (Shkodër, Lezhë). Kompozitë e formuar nga *ciri* + *pupe*, të dyja elemente onomatopeike. Elementi *ciri* lidhet me *cërcërin* e *cirikokë*, kurse *pupe* lidhet me kërcimin *pupas*, *pupthi*, *pupë*. Një fjalë tjetër që lidhet me këtë është *cilipupe* (Elezi) me kuptimin “e imtë shumë (për një vajzë)”.

cirlík fol. “bëjnë zhurmë rrotullat”. Fjalë krahinore e gegërishtes veriore, te Mjedja: *cirlíkne rrotllat posht’e perpjetë*. Krijim me bazë onomatopeike, si imitim i zhurmës që bëjnë rrotat kur rrotullohen. E ka Fjalori i Demës për “zhumhura qi bajnë rrotat e qerres tue u rrotullue”.

cirlúe m. “emër zogu, shtura, gargulli, lat. *Sturnus vulgaris*”. Është fjalë e dialektit gegë me përhapje krahinore. Në Tiranë e gjejmë në formën *cerrlu*, në Durrës *çarlue*. Lidhet përbrenda gjuhës me *cirlë*, emri i mëllenjës, që me prapashtesën e mocionit ka krijuar formën *cërлонjë*. Prej kësaj është formuar mashkullori *cirлонj*, që, duke u marrë si formë shumësi, ka krijuar njëjësën *cërlue*.

cizój fol. “nxjerr tingull të hollë e të zgjatur”: *cizojnë drutë në zjarr*. Fjalë krahinore e dialektit gegë (Mirditë). Bashkë me foljen *cëzoy* është formim onomatopeik, si imitim i tingullit që lëshojnë disa sende: *ciz ~ cëz* (rrj. *cizim*).

cjap m. “kafshë shtëpiake me brirë, mashkulli i dhisë, sqap, kec”. Fjalë e mbarë gjuhës me forma të ndryshme nëpër dialekte: geg. *sjap*, *skjap*, *sqap*, *cap*; tosk. *cap*, *cjap*, *cijap*, *cqap*, *cujap*. Dëshmohet për herë të parë te Buzuku: *en gjakut së sjepet*. Forma *sjap* edhe te Bardhi. Fjalë e trashëguar, që lidhet me emrin e kësaj kafshe, ie. *kapro* “sqap, cjap”, ku hyn gr. κάπρος “deri”, lat. *caper* “sqap” e *capreolus* “kapruall”, nord. vj. *hafr* “sqap”. Në gjuhën shqipe ka marrë prapashtesën *s-* (**s-kap*) dhe për evolucionin e fjalës ka luajtur rol shumësi. Nga një **skap* shumësi bën **skep* > *sqep*, prej së cilës ka dalë, nga njëra anë njëjësi *sqap*, dhe nga ana tjetër forma *sjep* > *cjep*, prej së cilës është formuar njëjësi *cjap* e *cap*. Mendimi i disa gjuhëtarëve (Meyer-Lübke, Jokl, Tagliavini, Çabej etj.), që marrin si pikënisje formën *cap* duke e lidhur me një krijim onomatopeik, nuk arrin të shpjegojë formën *sqap*.

Rrjedhoja të fjalës janë: *sjapól* (Malësi e Madhe), *sjapç*, emri i një bime zbukuruese, lat. *Tragopogon porrifolius*, nga përngjasimi i luleve të saj me brirët e cjapit, *caponjë* “dhi me brirë si të cjapit”, *caporr* “cjap ftujak me brirë përpjetë” (Myzeqe), *caporre* “lopë a dhi me brirë të gjatë” (Dumre), *capok* “cjap ftujak” (Krujë), *cjape* “kece, dhi”, *cabe* (Postribë) “dhi me brirë

të mëdhenj”, *cjapos* “e dobësoj”, *cjapthi* “qëndrim mbi dy këmbët e parme”, kompozita *cjapodhi* “me tipare të cjamin e të dhisë” etj. Ka depërtuar edhe në toponimi (*Guri i Capit* në Korçë). (Meyer EW 387, Pedersen KZ 36, 1900, 337, Weigand Wört. 78, Spitzer MRIW I 1914, 278, Meyer-Lübke REW 9599, Jokl WZM 1-2, 1927, 34, Fest. Salzburg 1927, 128, Tagliavini Strat. 133, Walde-Pokorny I 348, Walde-Hofmann I 157, Çabej SE III 50, Orel AED 47).

cúcë f. “vajzë, gocë”. Fjalë krahinore e gegërishtes, kryesisht e anëve lindore dhe e Shqipërisë së Mesme e Jugore. Në disa vise ka formën *cocë* me kthimin dialektor *-u- > -o-*. Shfaqet aty-këtu edhe në toskërishte, ndoshta nga ndikimi gegë. Fjalë me burim të diskutueshëm. Mund të jetë formim i brendshëm me prapashtesën *-cë* nga *cull* “fëmijë” (Çabej). Një lidhje tjetër mund të jetë me *cicë*, që përdoret edhe si antroponim për emër vajze (*Cice*), duke u shpjeguar ndryshimi i zanoreve (*-i- : -u-*) me sistemin fonoleksikor të shqipës (khs. *cik ~ cuk, cip ~ cup*). Rrjedhoja të fjalës janë: *cucni* “vajzëri”, *cucnisht, cucman* “frikacak” (Gazulli), për prapashtesën khs. *frikaman; cuckë* prej saj *cke* me haplologji (Lezhë, Lurë). Patronimi *Palokë Cuca* është krijuar prej Fishtës. (Miklosich AF I 315, Meyer EW 443, Tagliavini Strat. 113, Skok ER I 279, Jokl UJ 2, 1927, 82, Mann Lg. 26, 1950, 384, Çabej SE III 59, Orel AED 48).

cúcërr ndf. “shuk, grusht, i mbledhur nga frika: *u bë cucërr*, femër e ndrojtur (Elezi)”. Fjalë krahinore e gegërishtes VL, që ka zhvilluar rrjedhojat: *cucërrak* “galiç”, *cucërran* e *cucërraç* “i strukur nga frika”, *cucërrosh* “ai që hiqet si i druajtur, i turpshëm”, *cucërrohem* “strukem nga frika, druhem”. Të gjitha këto bashkohen te koncepti “frikë”, që përgjithësisht është lidhur me gratë, kurse trimëria është lidhur me burrat. Prandaj burimi i tyre është emri *cucë*, gjë që e provon mbiemri *cucman*, që Fjalori i Gazullit e ka për “frikacak”.

cuk fol. “pickon, ther, quq” (*të cuk bleta*), “cikat” (*cuk gështenjat*), “ngacmoj, cingëris” (*cuk nervat*). Është fjalë krahinore e dy dialekteve (Himarë, Elbasan etj.). Në të gjitha përdorimet e saj folja ka kuptimin “ther, pres”, prandaj lidhet përbrenda gjuhës me *cik* “prek”, që ka zhvilluar edhe kuptimin “ther, pickoj, thyej”; khs. *cikat gështenjat* “i pres lehtë që të mos kërcejnë në zjarr”, *cikem voesh* “ndesh dhe thyej vezët me njëra-tjetrën”. Kësisoj, *cuk* hyn në sistemin fonoleksikor të shqipës me zhvillimet *cik : cek : cok : cuk* e *qek : qok : quq*. Fjalori i Da Lecces ka *me cukatunë* për “rrah, godas”.

cull m. “djalë i vogël, fëmijë”, “lakuriq”. Fjalë e gegërishtes, me përhapje sidomos në gegërishten qendrore e verilindore (Durrës, Dibër, Lumë, Mat, Mirditë etj.). Kuptimi i parë i fjalës ka qenë “lëkurë”, gjë që del nga

rrjedhojat e saj, si: *cullak* "lakuriq", domethënë "në lëkurë, i paveshur", *cullnik* "trastë lëkure e bariut", *cúllat* (sh.) "shtupa të lehta, dru tape, lëkurë drurësh". Për lidhje të mëtejshme Çabej shënon se është me burim të dyshimtë. Mund të jetë krijim femënor, në fillim për organin seksual mashkullor, pastaj për femëinë mashkull e nga kjo në "lakuriq, lëkurë". Në të vërtetë, *lakuriq* thuhet kur zbulohet organi seksual, prandaj është e natyrshme një lidhje ndërmjet tyre. Sipas kësaj lidhjeje, me *cull* lidhet kuptimisht e fonetikusht *cole* "penisi i femijës" (Tetovë), *cylaq* "organi seksual i mashkullit të disa kafshëve" dhe arb. e Italisë *culaq* "organi seksual i derrave". Rrjedhoja të fjalës janë: *culllako* "zhvesh lakuriq" (rrj. *cullakim*), *cullnisht* "si femijët", *cullohem* "bëhem si femijë", *picullak* e *picllak* (rrj. *picllaksoj*), *bicúll* "lakuriq" (Mat). (Çabej SE III 63, SE IV 245, Orel AED 48).

cúmër m. "copë e shkurtër trunq, që shërben për t'u ulur ose për të mbështetur diçka", "cung që përdoret si jastëk", "trunq i pagdhendur që përdoret për stol", "këmbë shtrati". Me këtë fjalë lidhet edhe emri i një peshku, njëlloj qefulli, i shkurtër, i trashë e me bisht të vogël, lat. *Mugil cephalus*. Rrjedhoja të fjalës janë: *cumrak*, që përdoret për "cung i vogël", fig. "shkurtabiq" dhe për "qefull i ri" (rrj. *cumrakoj* "shkurtoj një trunq në disa pjesë"), *cumruk* "trangull i vogël", "njeri i pazhvilluar". Është fjalë e gegërishtes veriore, që lidhet përbrenda gjuhës me *thumbër* "kërcu që përdoret në disa krahina si nënkresë" me ndërrimin *c-* : *th-* duke shënuar edhe në këtë rast diçka të shkurtër e me majë e duke u lidhur me *thumb*, *thumbát* "kunj druri". Një lidhje tjetër, më e largët, mund të jetë me *cub* "bishtshkurtër" (Çabej), duke u lidhur përbrenda gjuhës me *cup* "cep, sup". (Çabej SE III 65).

curr m. "shkëmb i lartë i thepisur". Fjalë kryesisht e gegërishtes veriore e lindore, që e njohin edhe disa të folme të toskërishtes dhe arbërishtja e Italisë. Ka krijuar edhe kuptime të tjera, si: *cur* e *currë* "me veshë të shkurtër", *curre* "pelë me flokë të rrallë në ballë", *curr* "njeri me veshë të vegjël", *curr*, *curre* "njëlloj shtambe pa veshë" (çam.). Duke u nisur nga kuptimi "majë" (për shkëmbin) dhe "pres, cunqoj" (për veshët), *curr* lidhet përbrenda gjuhës me fjalët që kanë kuptime të tilla, si: *acar*, *carac*, *cërri*, "thumboj, ther", *cermë* "mahisje e kyçeve, ngërç", *cërmok* "shtuf", *cirë* "lëvorja e drurit, dru i qëruar nga degët, trunq pa degë", duke u shpjeguar me sistemin fonoleksikor të shqipes me shkallët vokalike *-a- ~ -e- ~ -i- ~ -o- ~ -u-* dhe konsonantike *c-* : *th-* (*ther ~ i thar(të) ~ (tër)thor ~ thur*). Shpjegimi i Çabejt prej një baze indoeuropiane me qiellzore të trashëguar duke e lidhur me arm. *sur* "shpatë" e het. *surna* "bri", duket i largët.

Rrjedhoja të fjalës janë: *curr*, *curroj* e *curras* "i pres veshët" dhe "ngre veshët përpjetë" (rrj. *currim*), *currel* "të gërryeme qi bajnë në shkambij ujnat" (Gazulli), *currak* "që i janë prerë degët", *curran* "me veshë të vegjël" dhe

“njeri i fortë si curri”, *currek* “shkëmb i vogël”, në Fjalorin e Da Lecces *curk* “me veshë të shkurtër”, mbiemri *i curmë* “curan” (Dema); foljet *me currue* e *me curratë* “me ngrehë veshët përpjete” (Gazulli). Fjala ka depërtuar në toponimi (*Curraj i Epër, Curraj i Poshtë, Currat e Bardhë* në Veri) dhe në antroponimi (*Curri, Curani, Cacurri*). Prej shqipes fjala ka shkuar edhe në disa ligjëtime serbe fqinje. (Jokl Stud. 115, Barić Arhiv II, 1924, 388, Çabej SE III 68, Orel AED 48).

Ç

ç’, çë. Përemër pyetës e lidhor “çfarë, çka, që”. Nga këto dy forma, *çë* është më e hershme, *ç’* është më e re. Zanozja *-ë* ka rënë në ngërthim të fjalisë (*çë është > ç’ është*). Është fjalë me burim të paqartë. E kanë dy dialektet e shqipes dhe arbërishtja e Italisë dhe Greqisë. Del te shkrintarët e vjetër; Matrënga: *Çë shërbes ishtë i krështë?* Buzuku ka përemrin *zhdo* “çdo”, që e përmban atë: *tue i lypunë zhdo kafshë en si*. Ky përemër është formuar në zhvillim të brendshëm të gjuhës duke u përdorur në krye të herës si përemër lidhor (ashtu si përemri (*i cili*) e më vonë si pyetës. Morfologjikisht *ç’* është formim i rasës kallëzore, meqenëse përgjigjet e pyetjeve që bëhen me këtë përemër, janë gjithnjë emra të kësaj rase. Skema e formimit të tij mund të ketë qenë (*a)të që* (p.sh., *merr atë që do*), ku, pas rënies së *-ë-së*, bashkëtingëlloret u shkruanë me njëra-tjetrën (*t- + që > çë*). Përemra të tjerë të formuar me *ç’* janë: *çka?* (geg.) nga *ç’ka*, *çfarë* nga *ç’farë*, *çdo* nga *ç’do*, *çmos*. Nga këta përemra janë krijuar disa forma “allegro”: *ça* nga *çka*, *çar* nga *çfarë*, *ço* nga *çdo* (*çoç, çokush*). Format *çaf* e *çav* (geg.) kanë dalë nga përdorimi i *-h-së* për të zhdukur hiatin në rastin e emëzimit të përemrit: *çkaheja > çkahja > çkaffja > çkaf > çaf*. Meqenëse ky përemër është i mbarë shqipes, burimi i tij nuk mund të shpjegohet me ndërrimin *që > çë* (Çabej), që ka karakter dialektor. (Bopp 517, Camarda I 68, Meyer EW 218, Treimer ZrPh. XXXVIII 1914, 388, Pedersen KZ 36, 1900, 328, Barić ARS I 48, Jokl Sprache IX 2, 1963, 141, Mann Lg. 28, 1952, 35, Orel Gr. 246, AED 52, Çabej SE III 73, Topalli Për. 155).

çakëllój fol. “bëj zhurmë duke goditur me diçka, gdhend”. Është formim prapashtesor nga një rrënjë me burim onomatopeik (**çak*) duke u lidhur përbrenda gjuhës me *çakëllój* “çokas (*çakëlloj gotat*), kërcëlloj (*i çakëllonin dhëmbët*)”.

çakth m. “qukapik, lat. *Picus maior*”. Fjalë me përhapje krahinore në të dy dialektet. Ky zog jeton në zgavrat e drurëve dhe me sqepin e tij të gjatë godet lëvoren e drurëve për të nxjerrë kandrra për ushqim; prandaj *çakth* është formuar me prapashtesën deminutive *-th* nga një rrënjë **çak* me burim

onomatopeik, si imitim i goditjeve të sqepit të zogut. Një emër tjetër i këtij zogu nga e njëjta rrënjë është *çakrraç*, me dy prapashtesa.

Burim onomatopeik nga rrënja **çak* ka edhe ndajfolja *çakthi* “dhëmb për dhëmb” (*e priti çakthi* “ashpër”), që ka marrë prapashtesën *-thi* të ndajfoljeve.

çamarrók m. “çapkën, i prapë”. Fjalë e dialektit toskë, e përgjithësuar në gjuhë. Është formim i brendshëm nga mbiemri *i marrë* me parashtesën *ça-* e prapashtesën *-ok* (khs. *marrok* e *marroqe*).

çámër f. “thërrime, dromcë”. Fjalë e gegërishtes veriore (Pukë). Mund të jetë formim i brendshëm nga folja *çaj* “ndaj, copëtoj”, pj. *çam*, që ka marrë prapashtesën *-ër*, me kuptimin “një pjesë e çame, e thyer”, khs. *thërrime* nga *ther*. Çabej e nxjerr nga *çapë* “kafshatë” me ndërrimin *p- > m-*. (Çabej SE III 83).

çanësój fol. “përkufizoj”. Është fjalë e re e shqipes, krijim intelektualësh, e formuar me parashtesën *ç-* e prapashtesën *-o* nga rrënja *anë* me kuptimin “tregoj anën, kufirin”.

çángë f. “pllakë metali ose copë gypi, së cilës i bien si sinjal”. Është krijim onomatopeik nga imitimi i tingullit që jep një pllakë metali kur goditet (*çang-çang*). Në Dibër me gjininë mashkullore *çang-u*. Përdoret edhe si patronim (Çanga në Shkodër, Çangu në Nikël të Krujës). Sipas Dizdarit vjen nga turq. *çan* “kumbonë e madhe”. (Dizdari 147).

çapéle f. “njëlloj bretkoce e madhe”. Fjalë e gegërishtes (Junk, Bashkimi). Është formim i brendshëm me prapashtesën *-el* dhe formantin *-e* të mocionit nga rrënja *çap*, e emërtuar kështu nga sytë e dalë e të zgurdulluar të bretkocës, khs. *çapëloj sytë* “zgurdulloj sytë”, *me sy të çapëluar*. Një lidhje me *çaprok* “plancuk, mullëmadh”, *çaprruk*, *çapër* “rrëshek, calik”, *çaprrukal* “me trup të vogël e mënyrë komike” me ndikim të *zhabë-s* (Çabej), paraqet vështirësi fonetike e kuptimore, duke marrë parasysh se fjalët e mësipërme kanë si burim një huazim krahinor nga sllavishtja (skr. *čäpra*). Me *çapër* “rrëshek, calik” shpjegohet vetëm *çapërkosë* e gegërishtes veriore, që është kryqëzuar me *bretkosë* duke u emërtuar kjo kafshë nga lëkura e saj (khs. *zhabë* “bretkosë” e “lëkurë, zhangël”. (Çabej SE III 86).

çápë f. “kafshatë”: *një çapë bukë*. Fjalë e dy dialekteve, me burim nga emri *çap* me kuptimin “çaj, pres”, meqenëse kafshata është një pjesë e prerë, një copë e çarë. Kuptimi “çaj” del edhe në rrjedhojat *çapëloj* e *çapëlej* “shqyej duke e hapur a duke e tërhequr në të dyja anët” (khs. edhe *çapëlon sytë* “i hap fort sa të shqyhen”). Prej *çap* ka dalë folja *përçap*, por krahas kësaj del forma më e thjeshtë *çap* “përçap, përtyp” (Bizë), në Plavë-Guci *çapit* “përçap,

përtyp”, në fjalorin e Demës *me çapitë* “me grimcues me dhambë”. Këtu hyn edhe *çapalis* “këpus litarin me dhëmbë”. Me *çap* lidhet edhe *çape* “lugë e madhe druri” (khs. *ha me çape*). Çabej e vë në dyshim lidhjen me *çap* dhe mendon se mund të kemi të bëjmë me një fjalë ekspresive, me një krijim elementar. (Çabej SE III 86).

çapók m. “thoi i fortë i disa shpendve shtëpiakë, kthetër”. Del edhe me forma tjera, si: *çapua* / *çepue*, *çapor*, në Dumre *çapokth* me prapashtesë deminutive. Në të gjitha rastet kemi formime prapashtesore nga rrënja *çap* me kuptimin “çaj, pres” (khs. *çapëloj* “shqyej, çaj”, *çapë* “kafshatë”, *çapë* “shat me teh si sqepar”). Lidhja me *çep* e *sqep* (Çabej) është më e largët. (Çabej SE III 89).

çaraveshem fol. “vishem keq, shtrembërohem në fytyrë, kërveshem, me u hapë tue u deformue (Dema)”. Fjalë e dialektit gegë, e formuar nga folja *vesh* dhe elementi *çara*, që i jep kuptim keqësues (khs. *çarraví*, *çarrakuq*, *çarravaja*). Rrjedhoja të fjalës janë: *çaravesht* “pa kujdes”, *i çaraveshtë*, *çaraveshujë*, *çaraveshajkë*, *çaraveshan* (Elezi).

çepëllë / çapëll f. “varg me fiq të thatë”, “lloj fiku me tul”. Fjalë me përhapje krahinore në të dy dialektet. E ka toskërishtja jugore dhe gegërishtja veriore, ku del me formën *çapell*. Është formim i brendshëm me prapashtesën *-ellë* (khs. *humbellë*) nga *çap* me kuptimin “çaj, hap”, meqenëse fjala përdoret për fiq që çahen në mes e bëhen varg. Me *çepëllë* lidhet *çepëllkë* “stërkungull, lat. *Bryonia dioica*” (Myzeqe), që ka marrë prapashtesën *-kë*. Mendimi i Meyerit, që e bie të ardhur nga it. *zampa*, nuk qëndron as nga kuptimi, as nga forma. Burimi i kësaj fjale nga sll. *čerep* “thërrmiqe gastaresh, lloj mangalli për të terur ndërresat” (Çabej) paraqet vështirësi fonetike e semantike. (Meyer NS II 89, Çabej SE III 106, 110).

çépka sh. “karthje të thata”. Fjalë me përhapje të ngushtë në toskërishte (Mallakastër, Labëri), që përdoret si shumë. Është formim me prapashtesën *-kë* nga *çep* (khs. *kërçep* “kërçu, gremç”). Një burim nga *çepka* “vile rrushi, vesh rrushi” me burim prej sllavishtes (Çabej) duket më i largët nga ana kuptimore.

çepójjë f. “borde, vrimë në mur”. Fjalë krahinore e gegërishtes (Gazulli). Është formim i brendshëm me prapashtesën *-ojë* (khs. *gjatojë*) nga *çep* “kënd, çip, qoshe”, me kuptimin “vrimë e hapur në qoshe të dhomës”.

çoç p. “diçka”. Fjalë me përhapje të gjerë në të folme të toskërishtes. Është përemër i pacaktuar, i formuar si shumica e përemrave të tjerë të këtij lloji, nga bashkimi i dy fjalëve: *ço* + *ç*. Elementi *ço* është një formë allegro e përemrit *çdo*, i cili, krahas *ço* ka dhënë edhe *xho*, me asimilim në

bashkëtingëllore (*çdo > xhdo > xho*). Kësaj trajte *allegro* të toskërishtes, gegërishtja i përgjigjet me një trajtë tjetër të tillë: *ça* për “çka”. Me këto dy elemente janë formuar një varg përemrash të pacaktuar, si: *çoç* e *xhoç*, *çoku* e *xhoku*, *çokush* e *xhokush*, *çokur* e *xhokur*. Formime të tjera me elementin *ço* janë: *çosá* “një copë herë”, *çocili ~ çocila* “secili ~ secila”, *çosaherë* “disa herë”. Mendimi i Çabejt që nisët nga trajta gege *zhdo* për të shpjeguar *xho* e *ço*, paraqesin vështirësi fonetike e dialekt-gjeografike, për arsye se këto trajta janë vetëm të toskërishtes. (Camarda I 214, Çabej SE III 127).

çóçër m. “cinxami, lat. *Troglodytes troglodytes*”, fig. “trupvogël, kacamic”. Fjalë dialektore e toskërishtes dhe gegërishtes jugore. Është krijim elementar për një gjë të vogël, ashtu si edhe *çuç* “i vogli i disa shpendve, që posa ka dalë nga veza”.

çup mb. “me veshë të shkurtër, curr”. Fjalë e dialektit gegë. Përdoret për kafshë me veshë të shkurtër (*dash çup*, *dele çupë*), për kafshë që s’ka brirë, shyt (*çjap çup*), për kafshë me bisht të prerë (*me bisht çup*), për kalli pa thekë (*grunë çup*). Lidhet përbrenda gjuhës me *cup* “bishtshkurtër”, *grunë cub* “pa hala”, *cubë* “dele a kafshë tjetër me bisht të prerë ose të shkurtër”, në Fjalorin e Rossit *cub* e *cup* “pa bisht”, fonetikisht me ndërrimin *c- > ç-*. Përdoret edhe si patronim (Mirditë). Rrjedhoja të fjalës janë: *çupkë* “dele me veshë të shkurtër”, “vegë ene”, “kungullujës”, fig. “krye” (Elezi), *çupoj* “shkurtoj, cunjoj” (rrj. *çupim*). Nga *çup* “kalli pa thekë” ka dalë *çupejkë* “majat e misrit që këputen për t’ua dhënë bagëtive si ushqim”, nga forma *çupëj* si një shumës i singularizuar.

SUMMARY

FROM “ETIMOLOGICAL DICTIONARY OF ALBANIAN” II

Bagolinë from it. *bagolina*; **bāj** : IE. *b^hor-*, Arm. *berem*, Gk. φέρω, Lat. *fero*; **bajgúsh** from *bajgë* + *-ush*; **bálla** from Mod. Gr. μπάλα; **báshkë** (*ba* + *-shkë*) : Got. *ba*, Germ. *beide*, Eng. *both*; **besëtýtë** from *besë* + *tytë*; **betéjë** from Fr. *bataille*; **bëltácë** from *baltë* + *-ac*; **bërbëlít** from *bër-bër* + *-it* (onomat.); **bërtás** from *brita* ~ *britë*; **bërzánë** from *bark-zanë*; **bërrákë** (*bë* + *rrakë*) : Rus. *reká* Anc. Ind. *ráyas*, Anc. Ir. *rían*, Lat. *rīvus*; **bërrýl** from *bë* + *rryl*; **bígë** from *bi* “two” + *-gë*; **binják** from Lat. *bīni* + *-ak*; **bízgë** from *bisk*; **bjerr** : IE. *b^her-*; **blegërin** : Sl. (Scr.) *blágo*; **blej** : IE. *b^hleu-*, Gr. φλέω, Lat. *fluo-ëre*; **blétë** from *mjaltë*; **blácë** from Sl. (Bulg.) блатце; **bllok** from It. *blocco*, Fr. *bloc*; **bóllëz** from *bollë*; **breróre** from *për-ar-ore*; **brëshkë** (*bre-shkë*), from *bre-j*; **bretk** from *bretëk*; **bróbull** from *bob-* (onomat.) + *-ull*; **brûç**

from **brum* (onomat.) + *-ç*; **brúfull** from **buf* (onomat.) + *-ull*; **brúmbull** from **bum(b)-* (onomat.) + *-ull*; **brydh** : *bry-dh* from *brij*; **búall** / **búell** from Lat. *bove(m)*; **búbë** from **bub* (onomat.); **bubullín** from *bu-bu* (onomat.); **buf** onomat.; **bufít** from *buf* + *-it* (onomat.); **bûj** : IE. *b^heu-*; **bújgër** from *bug-* (cf. *bung*) : Gr. φαγός, Lat. *fagus*; **bukós** from Mod. Gr. μπούκωσα (μπουκόνω); **bulb** from it. *bulbo*; **bulcí** from *bul-ç* (onomat.); **búlë** from Lat. *bullā*; **bulkth** from *bul-* (onomat.); **bulmét** : IE *mel-*, Gr. μέλας, Lat. *mulleus*; **bullúngë** from *bull-*; **burbuléc** from **burbul*; **burg** from Lat. *burgus*; **burón** / **bunón** < **bun*; **burth** from *bur-*; **bushíq** from *(m)bush*; **buzhél** from *bushíq* and *bushak*; *byc* from *bic* (< *bij*); **cabók** from *ca-* + *bokë*; **call** from *callangur* (*skallangur*); **camërdhók** from *ca-* + *mërdhok*; **cërcëré** from *cër-cër* (onomat.); **cërrán** from **cërr* (onomat.) + *-an*; **cërrfát** from **cërrf* (onomat.) + *-at*; **cërrlë** from **cërr* (onomat.) + *-lë*; **cërrón** from **cërr* (onomat.) + *-o*; **cíli** from *të sij* (*si*); **cimb** from *thim-th* and *thim-c*; **cimbúr** from **cimb* (cf. *cimbis* and *cimbon*); **cing** (onomat.); **cíngla** from **cing* (onomat.) + *-lë*; **círë** cf. *cërrit*; **ciripúpe** from *ciri* + *pupe* (onomat.); **cirlík** onom.; **cirlúe** from *cirlë*; **cizój** onomat.; **çjap** : IE. *kapro*, Gr. κάπρος, Lat. *caper*, *capreolus*, Old Nord. *hafr*; **cúcë** from *cull*; **cúcërr** from *cucë*; **cuk** : *cik* “touch”; **cull** a childish creation; **cúmër** cf. *thumbër* (*thumb*); **curr** cf. *acar*, *carac*, *cërris*; **ç'**, **çë** from *(a)të që*; **çakëllój** from **çak* (onomat.); **çakth** from **çak* (onomat.); **çamarrók** from *çā-* + *(i) marrë* + *-ok*; **çámër** from the verb *çaj*, part. *çam*; **çanësój** from *ç-anë-so*; **çángë** onomat.; **çapéle** from *çap* + *-el*; **çápë** from the name *çap*; **çapók** from *çap*; **çaraveshem** from *çara-* + *vesh*; **çepëllë** / **çapëll** from *çap* + *-ellë*; **çépka** from *çep* + *-kë* (cf. *kërçep*); **çepójë** from *çep* + *-ojë*; **çoç** from *ço* + *ç'*; **çóçër** an elementary creation, cf. *çuç*; **çup** from *cup*.